



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Gjuhëve Kulturave dhe Komunikimit
Menaxhimi dhe Udhëheqja në Arsim

STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

MENAXHIMI I KLASËS DHE STILI I MËSIMDHËNIES NË SHKOLLAT FILLORE NË MAQEDONINË E VERIUT

Kandidat:

Mirije Vrangalla

Mentor:

Prof. dr. Hasan Jashari

Tetovë, Maj, 2020

Deklaratë

Me përgjegjësi të plotë deklaroj se këtë punim e kam bërë unë dhe asnjëherë nuk është prezantuar para ndonjë institucioni për vlerësim dhe nuk është botuar më parë. Pra, punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Parathënie

Në radhë të parë shpreh mirënjohjen time të thellë për udhëheqësin tim Prof. Dr. Hasan Jashari, i cili iu përgjigj menjëherë kërkesës sime dhe gjatë gjithë kohës ka udhëzuar dhe asistuar procesin e këtij punimi.

Poashtu falenderoj të gjithë profesorët e lëndëve, të cilët më kanë inkurajuar dhe më kanë trajtuar me respekt, ashtu siç duhet trajtuar një student.

Falenderime u përcjell të gjithë drejtorëve të shkollave fillore që më mundësuan qasjen në shkolla dhe më lehtësuan përfundimin e këtij punimi.

U jam mirënjohëse të gjithë atyre që u bënë pjesë dhe kontribuan në hulumtimin tim, mësimdhënës, prindër, nxënës, pa mos lënë anësh kolegët dhe familjen time, pa mbështetjen e të cilëve nuk mund të vija deri këtu.

Abstrakt

Ky punim nxjerr në pah rëndësinë e menaxhimit të klasës dhe stilet e mësimdhënies në vendin tonë, në rastin konkret të disa shkollave fillore të Komunës së Kërçovës, ku objekt hulumtimi është vetë klasa e përbërë nga nxënësit dhe mësimdhënësit pa mos lënë anësh edhe prindërit.

Punimi është ndarë në katër kapituj, ku në kapitullin e parë i kemi lënë hapësirë qasjes së hulumtimit duke treguar qëllimet dhe objektivat, pyetjet e hulumtimit, hipotezat, metodologjinë, pjesëmarrësit, instrumentet me të cilat është kryer hulumtimi etj. Në kapitullin e dytë shtjellohet tema e menaxhimit të klasës, ekologjia e klasës, organizimi i punës në klasë, qëllimi dhe objektivat e klasës, klima, nxitja e mendimit te nxënësit, bashkëpunimi dhe vendosja e rregullave, dallimi ndërmjet klasës tradicionale dhe asaj të shek. XXI, vetitë dhe karakteristikat e mësuesit të mirë si dhe zhvillimi profesional i tyre, marrëdhëniet me prindërit etj. Kapitulli i tretë përfshin stilet e ndryshme të mësimdhënies, mësimdhënien efektive, sa duhet të aplikohet mësimi me logjikë, sa vendoset mësimi në praktikë si dhe strategji për të vetëorganizuar mësimin. Pra, në këtë punim është bërë një krahasim i aspektit teorik dhe praktik të menaxhimit të klasës dhe stilit të mësimdhënies. Në çdo temë janë cituar disa autorë si shqiptarë ashtu edhe të huaj, për të parë se si qëndrojnë teoritë e tyre ku më pas të njejtat janë krahasuar me praktikën dhe punën në klasë të shkollave të përfshira në studim me ndihmën e metodave të aplikuara. Në kapitullin e katërt apo të fundit janë analizuar rezultatet e anketimeve me nxënësit dhe prindërit duke i paraqitur ato me anë të grafikonëve dhe duke komentuar rreth të njejtave.

Poashtu duhet të potencohet se hulumtimi u bë nëpërmjet kontaktit me persona adekuat duke i intervistuar dhe anketuar me pyetësorë të parapërgatitur, me qëllim të krijimit të një pasqyre më të qartë për klasën dhe menaxhimin e saj. Në hulumtim janë përfshirë 5 shkolla fillore, në të cilat janë intervistuar 10 kujdestarë klasash apo mësimdhënës ku janë paraqitur këndvështrimet e tyre gjatë punimit të temës. Gjithashtu është përdorur edhe metoda sasiore ku me anketime janë përfshirë 75 nxënës përmes së cilëve nxirren të dhëna nga

këndvështrimet e tyre. Në shtojcë, pyetësorë janë përgatitur edhe për 40 prindër, për të parë mendimet dhe pritshmëritë që kanë ata nga fëmijët e tyre, kryesisht nga bashkëpunimi me mësimitdhënësit për të arritur një sukses më të lartë te fëmijët si nxënës, por edhe si individë. Puna e cilësisë së mësimitdhënies është hulumtuar nëpërmjet metodës së vëzhgimit të drejtpërdrejtë.

Ky studim është kryer për një muaj, pasi bëhet fjalë për disa shkolla dhe natyrisht se vendndodhja e tyre është e shpërndarë. Gjithë të dhënat dhe kontaktet me drejtorin, mësimitdhënësit, nxënësit dhe prindërit u zhvilluan me dëshirë dhe me shpresë për ndikim pozitiv për të gjithë këndvështrimet. Rezultatet e këtij studimi si dhe rekomandimet do të kontribuojnë për një angazhim më të madh, të cilat do t'u shërbejnë vetë shkollave, pra mësimitdhënësve, nxënësve si dhe shoqërisë në përgjithësi.

Fjalë kyçe

Menaxhim, klasë, mësimitdhënës, nxënës, stili i mësimitdhënies.

Abstract

This paper highlights the importance of classroom management and teaching styles in our country, especially in some primary schools in the Municipality of Kichevo, where the object of study is the classroom itself consisting of students and the teachers without neglecting the parents.

This paper is divided in four chapters, where the first chapter is about the research approach listing the goals and objectives, the research questions, the hypothesis, the methodology, the participants, the instruments etc. In the second chapter is elaborated the topic of the classroom management, organizing classroom work, the goals and objectives of the classroom, the cooperation and regulation, the ecology of the classroom, the climate, encouraging student thinking, the difference between the traditional classroom and the classroom of the XXI century, the characteristics of a good teacher and their professional development, the relations with the parents etc. The third chapter includes different teaching styles, the effective teaching, how much logic teaching should be applied, how much the lesson is put into practice and strategies to self-organize learning. So, in this paper a comparison has been made of the theoretical and practical aspect of classroom management and teaching style. Several authors, both Albanian and foreign, have been cited in each topic to see how their theories stand, where they are then compared to the practice and classroom work of the schools involved in the study with the help of applied methods. The fourth or final chapter analyzes the results of surveys with students and parents presenting them by charts and commenting on the same.

It should also be noted that the research was conducted through contact with adequate persons by interviewing and surveying them with prepared questionnaires, in order to create a clearer picture of the classroom and its management. The research included 5 primary schools, in which 10 head teachers were interviewed, where their views were presented while working on the topic. Quantitative methods have also been used where surveys have included 75 students through whom data are extracted from their perspectives. In addition, questionnaires

are prepared also for 40 parents, to see their thoughts and expectations they have from their children, mainly from their cooperation with the teachers to achieve greater success for their children as students, and as individuals also. The quality teaching work has been researched through the method of direct observation.

This study is done within a month, as it is about some schools and of course their location is scattered. All the information and contacts with the director, the teachers, the students and the parents were developed with desire and hope for positive influence in all perspectives. The results of this study and the recommendations will serve for major commitment, which will serve the schools themselves, ie teachers, students and all the society.

Key words

Management, classroom, teachers, students, teaching style.

Titulli punues i temës

“Menaxhimi i klasës dhe stili i mësimdhënies në shkollat
fillore në Maqedoninë e Veriut”

Përkthimi i titullit punues në maqedonisht:

“Управување со училницата и стилот на настава во
основните училишта во Северна Македонија”

Përkthimi i titullit punues në anglisht:

“Classroom management and teaching style in
elementary schools in North Macedonia”

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| Deklaratë | 1 |
| Parathënie | 2 |
| Abstrakt | 3 |
| Fjalë kyçe | 4 |
| Abstract | 5 |
| Key words | 6 |
| Titulli punues i temës | 7 |
| Përmbajtja | 8 |
| Lista e grafikëve dhe tabelave | 10 |
| Hyrje | 11 |
| KAPITULLI I - QASJA E HULUMTIMIT | 13 |
| Lënda e hulumtimit | 13 |
| Qëllimet dhe objektivat e hulumtimit | 14 |
| Pyetjet për hulumtim | 15 |
| Hipotezat | 15 |
| Metodologjia | 16 |
| Pjesëmarrësit | 16 |
| Instrumentet | 17 |
| Rëndësia e punimit | 17 |
| Përkufizime | 18 |
| KAPITULLI II - MENAXHIMI I KLASËS | 19 |
| Funksonet themelore të menaxhimit në menaxhimin e klasës | 20 |
| Ekologjia e klasës | 21 |
| Fillimi dhe përfundimi i mësimit | 22 |
| Organizimi i punës në klasë | 24 |
| Organizimi frontal | 24 |
| Puna në grupe | 24 |
| Puna mësimore në çifte | 25 |
| Forma individuale - mësimi i individualizuar | 25 |
| Qëllimi dhe objektivat e klasës | 26 |
| Klima | 28 |
| Nxitja e mendimit tek nxënësit | 29 |

| | |
|--|----|
| Shprehje me përkrahje pozitive dhe negative të mendimit të lirë në klasë | 32 |
| Bashkëpunimi dhe vendosja e rregullave në klasë | 33 |
| Rregulla disiplinore | 34 |
| Klasa e shek. XXI | 37 |
| Klasa tradicionale dhe klasa e shekullit XXI | 39 |
| Mësuesi i mirë | 41 |
| Vetitë dhe karakteristikat e mësuesit të mirë | 43 |
| Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve | 45 |
| Bashkëpunimi me prindërit | 47 |
| KAPITULLI III - STILI I MËSIMDHËNIES | 49 |
| Mësimdhënia efektive | 50 |
| Stile të ndryshme të mësimdhënies | 51 |
| Strategji për të vetëorganizuar mësimin | 54 |
| Memorizimi apo logjika | 56 |
| Praktika | 58 |
| KAPITULLI IV - ANALIZA E REZULTATEVE | 59 |
| Rezultatet e anketës së realizuar me nxënësit | 59 |
| Rezultatet e anketës së realizuar me prindërit | 63 |
| Përgjigjet kyçe nga intervistat e realizuara me mësimitdhënësit | 66 |
| Përfundimi | 68 |
| Diskutim rreth hipotezave | 71 |
| Rekomandime | 72 |
| Bibliografia | 75 |
| Webografia | 77 |
| Shtojca | 78 |
| Shtojca numër 1 - Intervistë me kujdestarët e klasave dhe disa mësimitdhënës | 79 |
| Shtojca numër 2 - Pyetësor për nxënësit | 80 |
| Shtojca numër 3 - Pyetësor për prindërit | 81 |
| Shtojca numër 4 - Vëzhgimet e drejtpërdrejta në klasë | 82 |

Lista e grafikëve dhe tabelave

Grafiku 1. Si qëndron ekologjia dhe klima e klasës tuaj?

Grafiku 2. Si punoni më shpesh gjatë orës mësimore?

Grafiku 3. Sa e nxisin mësuesit të menduarit kritik dhe anën kreative që keni ju si nxënës dhe a përdorin shprehje motivuese në klasë?

Grafiku 4. Kush i vendos rregullat e përgjithshme dhe disiplinore në klasë?

Grafiku 5. A përdorin mësuesit stile të ndryshme për t'ua lehtësuar mësimin?

Grafiku 6. Mësuesi kërkon që mësimin ta mësoni përmendësh apo ta thoni ashtu si e keni kuptuar?

Grafiku 7. Sa e vendosni në praktikë njësinë e mësuar?

Grafiku 8. Si qëndron marrëdhënia me mësime dhënësit e fëmijës tuaj?

Grafiku 9. A jeni të informuar me qëllimet dhe objektivat e vendosura në klasën ku mëson fëmiju juaj?

Grafiku 10. Sa nxisin mësime dhënësit mendimin kritik, problemor dhe krijues tek fëmiju juaj?

Grafiku 11. Mësuesi i fëmijës tuaj kërkon që fëmija të mësojë përmendësh apo vetëm të kuptojë atë që ka mësuar?

Grafiku 12. A i vendosin në praktikë gjërat që i mësojnë në klasë?

Tabela 1. Shprehje me përkrahje pozitive dhe negative të mendimit të lirë në klasë.

Tabela 2. Karakteristikat e klasës tradicionale dhe asaj moderne.

Hyrje

Njëra ndër arsyt e këtij hulumtimi është të mësojmë se si duhet të menaxhohet klasa dhe cilat stile të mësimdhënies aplikohen në shkollat tona. Ajo që nxit këtë hulumtim është të nxirren në pah të gjitha aktivitetet e mësimdhënësve, të cilët posedojnë rolin kyç për suksesin dhe mbarëvajtjen e gjithë punës në klasë dhe të cilët mbajnë përgjegjësi për gjitha ndodhitë brenda klasës, prandaj dhe si objekt hulumtimi i këtij punimi është vetë klasa me mësimdhënësin në krye. Motivi më specifik për realizimin e këtij punimi është të shihet se mësimdhënësit si menaxhues të klasës por edhe si ligjërues, a janë të aftë apo më mirë të thëmi a e bëjnë punën e tyre ashtu siç duhet, pra a i kushtohet vëmendje funksionimit të mirëfillt të klasës dhe në çfarë niveli qëndron cilësia e mësimdhënies. Poashtu nuk janë lënë anësh nxënësit, të cilët janë bashkëpunëtorë në të gjithë aktivitetet dhe arsya kryesore për të cilët ekziston edhe shkolla, si dhe prindërit, të cilët në mënyrë indirekte afektohen nga veprimet që ndodhin në shkollë për shkak të mirëqenies së fëmijëve të tyre.

Rëndësia e këtij hulumtimi është të paraqesë aspektet teorike dhe praktike në menaxhimin e klasës duke treguar se a zbatohen ato, apo qëndrojnë vetëm në letër. Studimet e mëhershme por edhe të tanishme tregojnë se çdo reformë bëhet për ta ngritur cilësinë në arsim. Prandaj rëndësia teorike, por më shumë praktike e këtij hulumtimi është se ne të gjithë kemi kaluar një pjesë të jetës sonë në klasë, dhe ajo që është më e rëndësishme se edhe fëmijët apo pasardhësit tanë do të mësojnë në shkollë, e cila duhet të jetë në nivel dhe të ofrojë kushte dhe mësim cilësor për të gjithë.

Hulumtimi do të realizohet duke përdorur disa lloje metodash si: metodën cilësore, sasiore, vëzhguese dhe analitike. Sa i perket metodës cilësore dhe sasiore, gjatë hulumtimit do të organizohen intervista dhe anketime me mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit. Me anë të metodës së vëzhgimit, e cila do ndihmojë si metodë paralele me të tjerat, do të bëhen disa vëzhgime në klasë për të qenë dëshmitare se si mësimdhënës të caktuar menaxhojnë klasën

dhe orën mësimore dhe çfarë stili të mësimdhënies përdorin në shkollat fillore. Dhe në fund metoda analitike do të ndihmojë në analizimin e të dhënave të përgjithshme.

Roli i mësimdhënësve do të ndikonte në cilësinë e klasës duke arritur sukses nëpërmjet punës së përkushtuar dhe të menaxhuar me kujdes, dhe supozohet se nëpërmjet bashkëpunimit dhe marrëdhënieve të mira me nxënësit si dhe me një zhvillim të pandalur të urës me prindërit, do të mundësohej një bashkëpunim më efikas dhe me këtë shkollat e vendit tonë do ta rrisnin dukshëm cilësinë e përgjithshme dhe së bashku do të ndihmonin në zhvillimin e gjithë procesit edukativo-arsimor.

KAPITULLI I - QASJA E HULUMTIMIT

Lënda e hulumtimit

Duke u bazuar në punën e përgjithshme që bëjnë shkollat, gjë që është tentim i prodhimit sa më kualitativ të gjeneratave, është e arsyeshme të bëhet një hulumtim rreth punës së shumfishtë dhe shumë personave të involvuar në këtë proces. Për të qenë më konkret, si lëndë hulumtimi ky punim do të ketë klasën apo më saktësisht menaxhimin e duhur të saj, i cili realizohet nga ana e vetë mësimeve si dhe stilet e mësimit dhe aplikimin e tyre në shkollat fillore. Në këtë proces sigurisht se kanë ndikim edhe faktorë tjerë të rëndësishëm duke filluar që nga drejtori e deri te personeli, por mësuesi është ai që ballafaqohet në mënyrë direkte dhe konkrete me këtë detyrë, dhe i njëjti ndër të tjera duhet të posedojë edhe aftësi menaxheriale me qëllim që klasën ta shndërron në një vend sa më të përshtatshëm dhe atraktiv për t'u zhvilluar më tej pa probleme mësimit i mirëfillt, i cili është edhe vetë misioni i shkollave. Emmer (1994) thekson se “sjelljet menaxheriale të mësuesit kanë të bëjnë me organizimin e klasës, vendosjen e sjelljes së duhur, parandalimin e problemeve dhe menaxhimin e sjelljeve disruptive”. Ndërkaq, Miller (1995) gjeti se “kur mësuesit ishin të suksesshëm në menaxhimin e sjelljes në klasë, ata kishin më shumë gjasa t'ia atribuonin këtë sukses përpjekjeve të tyre. Ky atribim i suksesit të menaxhimit ka lidhje direkte me besimet e efikasitetit të mësuesve”.

Gjatë këtij studimi do të përpiqem të rendis karakteristikat e një klase moderne, kryesisht të sajohet dallimet ndërmjet klasës tradicionale dhe asaj bashkëkohore, pastaj faktorët kryesorë në menaxhimin efektiv të klasës, rëndësinë e praktikave të menaxhimit efektiv të klasës, si të menaxhohen procedurat dhe rutinat, menaxhimi i sjelljes dhe disiplinës së nxënësve, menaxhimi i mësimit, praktikat dhe procedurat e mësimit, karakteristikat e një mësuesi të mirë, nxitja e mendimit kritik, problemor dhe krijues nga ana e mësuesit, shprehjet me përkrahje pozitive që duhet të përdoren në klasë, stilet që përdoren gjatë mësimit në shkollat fillore etj. Në këtë hulumtim poashtu do të hulumtohet edhe përgatitja profesionale e mësimeve, pra a janë të përgatitur dhe të trajnuar që të menaxhojnë klasën bashkëkohore.

Ky studim në përgjithësi ka të bëjë me drejtimin e klasës, formimin e grupeve, fillimin dhe përfundimin e mësimit, llojet e stileve të mësimdhënies, ekologjinë e klasës, klimen, motivimin e nxënësve, vetitë e mësimdhënësit, komunikimi me nxënësit, mbajtja e disiplinës në klasë, dhe gjëra tjera në shkollat fillore të cilat kërkojnë menaxhim të mirë.

Qëllimet dhe objektivat e hulumtimit

Qëllimi i këtij studimi është të tregojë se si duhet të menaxhohet, të duket dhe të funksionojë një klasë bashkëkohore në krye me mësimdhënësin, një njeri me veti të larta, i cili rrit mundësitë e zhvillimit të një klase bashkëkohore, duke nxitur dhe prirë proceseve në klasë për një mësimdhënie dhe mësimnxënie të avancuar. Poashtu përpiqet të sigurojë që reflektimi i mësimdhënësve të suksesshëm është një klasë, madje një shkollë e suksesshme dhe e kundërta.

Ndër të tjera qëllimi i këtij studimi është që të kuptojmë se çdo të thotë një menaxhim efektiv i klasës dhe të identifikojmë se cilat janë teknikat që e bëjnë efektive organizimin e orës mësimore si dhe do të diskutojmë metodat, strategjitë dhe stilet e mësimdhënies dhe sa aplikohen ato në shkollat fillore të vendit tonë. Në përgjithësi ky punim do të zbulojë nëse aspektet teorike në menaxhimin e klasës bashkëkohore dallojnë me aspektet praktike, të përbashkëtat e tyre dhe dallimet, pra të shkruara në letër dhe përditshmëria në punë, zbatimimi në praktikë.

Si objektiva specifike rendisim:

- Të shohim a përputhen aspektet teorike dhe praktiken me njëra tjetrën.
- Të vërtetojmë se roli vendimtarë qëndron tek mësimdhënësi për krijimin e një klime pozitive në klasë.
- Menaxhimi i mirë i klasës si dhe aplikimi adekuat i stileve të mësimdhënies ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollat fillore.

Pyetjet për hulumtim

- A dallon aspekti teorik nga ai praktik në menaxhimin e klasës?
- Si duhet të menaxhohet klasa dhe cilat stile të mësimdhënies duhet përdorur në shkollë fillore?
- Sa kontribon mësimdhënësi në krijimin e atmosferës pozitive në klasë?
- Cilat janë dallimet e klasës bashkëkohore dhe asaj tradicionale?
- Çfarë hapash duhet të ndërmerren për ta përmirësuar klimën?
- A duhet trajnuar në vazhdimësi mësimdhënësit për të pasur një klasë bashkëkohore?

Hipotezat

- Menaxhimi i mirë i klasës rrit cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpër shkollat fillore.
- Klasa bashkëkohore figuron në teori dhe në praktikë.
- Menaxhimi i klasës në mënyre bashkëkohore duke aplikuar stilet adekuate të mësimdhënies mundëson krijimin e një atmosfere efektive, të dobishme, stimuluese dhe pozitive të të nxënit.
- Klasa e shek. XXI është klasë e së ardhmes.

Metodologjia

Metodologjia është procesi gjatë së cilit veprojmë duke përdorur metoda të ndryshme, thënë ndryshe metodologjia është art i bërjes së shkencës. Me qëllim që të pasqyrohet një analizë sa më objektive e këtij studimi, ky punim do të bazohet në metodën e thjeshtë të rastësishme të kampionimit si dhe në metodën e orientuar gjykuese. Hulumtimi do të realizohet duke përdorur disa lloje metodash si: metodën cilësore, sasiore, vëzhguese dhe analitike. Sa i perket metodës cilësore dhe sasiore, gjatë hulumtimit do të organizohen intervista dhe anketime me mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit. Me anë të metodës së vëzhgimit, e cila do të përdoret si metodë paralele për plotësimin dhe verifikimin e të dhënave që do të marrin nga metodat tjera, do të bëhen disa vëzhgime në klasë për të qenë dëshmitare se si mësimdhënësi të caktuar menaxhojnë klasën dhe orën mësimore dhe çfarë stili i mësimdhënies përdoret në shkollat fillore. Dhe në fund metoda analitike do të ndihmojë në analizimin e të dhënave të përgjithshme.

Pjesëmarrësit

Me qëllim të gjetjes së faktorëve që ndikojnë në menaxhimin e mirë të klasës, në aspektin teorik dhe praktik, ndikimin e mësimdhënësit në rritjen e cilësisë në klasë e çështjeve tjera cekur më lart, do të përfshihen 5 shkolla fillore, ku do të intervistohen 10 kujdestarë klasash apo mësimdhënësi, gjithashtu do të bëhet një pyetësorë për 75 nxënës përmes së cilëve do të nxirren të dhëna nga këndvështrimet e tyre. Në shtojcë, pyetësorë do të shpërndahen edhe për 40 prindër, për të parë mendimet dhe pritshmëritë e tyre.

Instrumentet

Ky hulumtim do të bëhet nëpërmjet intervistave, pyetësorëve dhe vëzhgimeve në klasë. Pas kësaj do të mblidhen dhe do të analizohen të dhënat duke i paraqitur ato në forma adekuate në punim dhe më pas do të komentohen dhe do të nxirren konkluzione për secilën. Poashtu do të bëhet krahasim ndërmjet menaxhimit të klasës në teori dhe sa i njejt i aplikohet në praktikë. Është e rëndësishme të potencohet se hulumtimi do të bëhet nëpërmjet kontaktit me persona adekuat duke i intervistuar me pyetje të përgatitura paraprakisht si dhe duke i anketuar me pyetësorë të parapërgatitur dhe duke vëzhguar personalisht në klasë me qëllim të krijimit të një pasqyre më të qartë për shkollën, më konkretisht të shohim se si zhvillohet mësimi në shkollat fillore, pra çfarë lloj stilesh të mësimdhënies përdoren, sa është niveli i cilësisë dhe si menaxhohet klasa.

Rëndësia e punimit

Rëndësia apo qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të paraqesë aspektet teorike dhe praktike në menaxhimin e klasës duke treguar se a zbatohen ato, apo qëndrojnë vetëm në letër. Studimet e mëhershme por edhe të tanishme tregojnë se çdo reformë bëhet për ta ngritur cilësinë në arsim. Prandaj rëndësia teorike, por më shumë praktike e këtij hulumtimi është se ne të gjithë kemi kaluar një pjesë të jetës sonë në klasë, dhe ajo që është më e rëndësishme se edhe fëmijët apo pasardhësit tanë do të mësojnë në shkollë, e cila duhet të jetë në nivel dhe të ofrojë kushte dhe mësim cilësor për të gjithë.

Meqenëse do të bëhet një analizë rreth klasave të disa shkollave fillore, shpresoj që ky punim sadopak të japë një pasqyrë rreth menaxhimit të klasës si dhe një kontribut në këto pesë shkolla por edhe më gjerë, duke marrë parasysh rekomandimet e punimit dhe duke punuar në përmirësimin e mësimdhënies dhe menaxhimit më të mirë për të pakësuar apo eliminuar mangësitë e përgjithshme si të klasës poashtu edhe të shkollës në përgjithësi.

Përkufizime

Menaxhimi është arti dhe shkenca e vendimmarrjes dhe udhëheqjes. Një proces i veçantë që përfshin planifikimin, organizimin, drejtimin, kontrollin dhe vlerësimin për të përmbushur objektivat e paracaktuara të një institucioni nëpërmjet përdorimit të koordinuar të burimeve njerëzore dhe materiale.

Menaxhimi i klasës është vendosja e rregullit në klasë për zhvillimin normal të mësimin sipas planifikimit që është synim dhe shqetësim për çdo mësues. Një nga qëllimet e menaxhimit të klasës është mbajtja në vazhdimësi e një mjedisi mësimor pozitiv dhe të frytshëm.

Me stilet e mësimdhënies kuptojmë mësimdhënien gjatë se cilës përmbushen objektivat, aktivizohet nxënësi, nxitet ndërveprimi, përdorën pyetje të niveleve më të larta, ku nxënësi është në qendër të mësimdhënies, zhvillohen aftësitë, të menduarit kritik e krijues, bëhet reflektimi dhe nxënësi aftësohet për të punuar në mënyrë të pavarur.

KAPITULLI II - MENAXHIMI I KLASËS

Të menaxhosh një klasë do të thotë të kesh mjeshtri dhe aftësi menaxheriale dhe organizuese. Ajo që është më e rëndësishme për të arritur, është përfshirja e nxënësve në mësim me qëllim të realizimit të objektivave të parashikuara. Për mësuesit, menaxhimi i klasës është thelbësor.

Menaxhimi i klasës kryesisht shihet si disiplinë dhe menaxhim i sjelljes jo të mirë të nxënësve. Por, mësimdhënia e suksesshme kërkon më shumë sesa kontrollimin e sjelljes së nxënësve. Sipas (Evertson & Harris, 1999: 60) "kuptimi i termit të menaxhimit të klasës ka ndryshuar nga përshkrimi i praktikave të disiplinës dhe ndërhyrjeve të sjelljes në shërbimin si një përshkrues më i përgjithshëm i veprimeve të mësuesve në orkestrimin e ambienteve mësimore mbështetëse dhe ndërtimin e komunitetit". (Brophy, 1999: 44) bëri jehonë kur deklaroi se "mësuesit më të suksesshëm i qasen menaxhimit si një proces i krijimit dhe mbajtjes së mjediseve efektive të të nxënësve". Më në fund, (Larrivee, 2005: Vi) vuri në dukje se "menaxhimi i klasës është një përbërës kritik në përzierjen e treanshme të strategjive efektive të mësimdhënies, i cili përfshin përmbajtje kuptimplote, strategji të fuqishme mësimore dhe një strukturë organizative për të mbështetur mësimin produktiv". Mësimdhënësit e suksesshëm përdorin strategji "për krijimin e rregullave dhe procedurave, organizimin e grupeve, monitorimin dhe shtrirjen e ngjarjeve në klasë, dhe reagimin ndaj sjelljes së keqe" (Borko & Putnam, 1995: 41), dhe, kur bëhet mirë, "duket e qetë, madje edhe e padukshme" (Randolph & Evertson, 1995: 17). Pavarësisht nga të kuptuarit se menaxhimi i klasës është një grup kompleks aftësishë që përfshin shumë më tepër sesa të jesh i aftë të ndikosh dhe të kontrollosh sjelljen e nxënësve, mbetet një pershtypje e përgjithshme që menaxhimi i klasës ka të bëjë kryesisht me "disiplinën".

Funksionet themelore të menaxhimit në menaxhimin e klasës

Menaxhimi i klasës fillon me ndërtimin e besimit dhe marrëdhënieve, pa prezencën e të cilave është e vështirë të zhvillohet mësim normal në klasë. Këto marrëdhënie fillojnë të ndërtohen që nga dita e parë duke kaluar nëpër disa faza derisa nxënësit ndjehen të lirë dhe shprehin gatishmërinë e tyre për mësim. Mësuesi duhet t'i stimulojë fëmijët të marrin pjesë aktive në planifikimin, rregullimin dhe mbajtjen e klasës. Rreth kësaj (Zylfiu, 1985: 75) thotë se "arsimtari ose mësimitdhënësi po ashtu është faktor subjektiv me rëndësi në punën mësimore, i cili me aftësinë e tij profesionale dhe përgatitjen didaktiko-metodike planifikon, organizon dhe realizon tërë punën me nxënës, si dhe mundëson krijimin e kushteve elementare për kryerjen e suksesshme të punës mësimore". Pra çdo menaxher, në këtë rast çdo kujdestarë klase që e menaxhon klasën duhet patjetër t'i posedojë katër funksionet themelore të menaxhimit.

Planifikimi është hapi i parë që bëhet për të filluar me sukses, i cili ndihmon mësuesin të mendojë për stilin e të nxënësve, objektivat mësimore, strukturën dhe përmbajtjen e mësimit, kursen kohën etj. Këtu përfshihet edhe plani ditor.

Përveç planifikimit, mësuesi duhet të jetë edhe organizues i mirë. Ai duhet të organizojë klasën sipas interesit të nxënësve, ashtu që ata do të jenë të stimuluar të mësojnë dhe të zhvillohen. Ndër të tjera ai duhet bashkë me nxënësit të krijojnë dosje, ku puna e secilit nxënës të ruhet aty. Kur nxënësit punojnë në një përrallë, lexojnë një libër, shkruajnë vjershë ose vizatojnë, ata janë të motivuar që punën e tyre ta ruajnë në vend të veçantë. Në këtë mënyrë nxënësit do të dinë ku t'i gjejnë punimet e veta. Poashtu duhet të krijojnë edhe portofole, të cilat mund t'i dërgojnë edhe në shtëpi për t'ua treguar prindërve, dhe në këtë mënyrë edhe prindërit do të mund të shohin ecurinë e fëmijëve të tyre. Organizimet e këtilla do t'u ndihmojnë nxënësve të ndihen të sigurt dhe të lumtur në ambientin ku mësojnë.

Një nga vetitë më të rëndësishme të mësimitdhënësit është udhëheqja, e cila mund të definohet si aftësi për të ndikuar te nxënësit dhe që rezulton në sjelljen dhe gatishmërinë e tyre për kryerjen e detyrave të parapara.

Pas udhëheqjes vjen kontrolli, i cili shkon bashkë me vlerësimin dhe nuk duhet të bëhet vetëm në fund të orës mësimore apo në fund të vitit shkollor, por duhet të bëhet në vazhdimësi. Këtu përveç kontrolleve tjera përfshihet edhe kontrolli i dijes së nxënësve apo vlerësimi si dhe kontrolli i detyrave të shtëpisë, gjë që mësimdhënësit gjithmonë thonë se s'kanë kohë për ato. Nëse kontrolli lihet pas dore, mund të ketë ngecje në proces ndërsa mësuesi as që do të jetë i vetëdijshëm se është duke ndodhur një gjë e tillë.

Duke u bazuar në doracakun e (Walsh, Kiranxhiska & Gjorgjieva, 116), mund të shohim se "mësuesi duhet të mundësojë kushte të këndshme, të sigurta, të shëndosha të cilat i stimulojnë fëmijët të hulumtojnë, të mësojnë dhe të bëhen të pavarur". Poashtu në vazhdim gjenden disa metoda se si mund ta menaxhojmë klasën:

1. Mundësoni vend të sigurt për fëmijët, i cili lehtë mund të mbikëqyret
2. Mundësoni vend të këndshëm për fëmijët në të cilin ato do të ndihen komfort gjersa marrin pjesë në aktivitetet e ndryshme
3. Organizoni klasën sipas interesit të tyre, ashtu që fëmijët do të jenë të stimuluar të mësojnë dhe të zhvillohen
4. Përdorni materiale të ndryshme adekuate të cilat do të jenë të disponueshme lehtë për fëmijët dhe do t'i stimulojnë që të hulumtojnë, lozin dhe mësojnë
5. Stimuloni fëmijët të marrin pjesë aktive në planifikimin, rregullimin dhe mbajtjen e klasës
6. Modifikoni klasën që t'u përshtatet nevojave të disa ose të një grupi të fëmijëve
7. Shfrytëzoni rrethin e shkollës si burim prej të cilit mund të mësohet.

Ekologjia e klasës

Duke u bazuar në librin e (Musai, 2003: 205), një tjetër gjë e rëndësishme është ekologjia e klasës. Si çdo mjedis, përmendëm se edhe klasa ka rregullat e veta për mirëmbajtje, të cilat nuk duhet te thyhen. Përveç vendimeve të menjëhershme që duhet të ndërmerren, në klasë ekzistojnë edhe shumë detyra parësore, të cilat nuk duhen injoruar, pastaj aty është edhe njëkohshmëria, ku kërkohët që në të njejtën kohë të zhvillohen disa veprime, pasi që kemi të bëjmë me një numër të konsiderueshëm të nxënësve në klasë, të cilët kanë edhe nevoja të veçanta. Poashtu çdo klasë ka historinë e saj, me të cilën nënkuptojmë se gjithçka që ka ndodhur prej në fillim të vitit shkollor, mbahet mend.

Nëse marrim parasysh përgjigjet e kujdestarëve të klasave të intervistuar dhe nxënësit e anketuar, (shih shtojcën 1 dhe 2), lirisht mund të themi se klasat e këtyre pesë shkollave kanë një ekologji mesatare.

Fillimi dhe përfundimi i mësimit

Sipas (Brophy, 2003: 9) “mësuesit e mirë përcjellin idenë e rëndësisë së shkollimit dhe të nevojës për të përfituar sa më shumë nga koha e vënë në dispozicion. Ata i fillojnë dhe i mbarojnë orët e mësimit në kohë, tranzicionet i bëjnë të shkurtra dhe iu mësojnë nxënësve se si të përqëndrohen dhe të fillojnë menjëherë me zgjedhjen e detyrave”. Në ndërkohë (Musai, 2003: 206-207) rreth fillimit të mësimit thotë “dy aspekte më të rëndësishme që kanë të bëjnë me fillimin e mësimit janë përpikmëria dhe rregullimi mendor”. Sa i përket të parës është e rëndësishme dhe mjaft efektive për nxënësit, nëse arsimtari arrin me kohë ta fillojë procesin mësimorë, madje përpikmëria, në këtë drejtim, do t’u dërgonte mesazhe nxënësve se sa është i nevojshëm, i drejtë dhe racional, respektimi i kohës dhe orarit të mësimit. Zakonisht minutat e parë janë periudhë e parapërgatitjes, ngase në njërin anë mësimit shënon orën

mësimore, ndërsa, në anën tjetër, nxënësit përgatisin materialin që u nevojitet gjatë asaj ore. Sipas vëzhgimeve të kryera në shkollat e përfshira në studim, (shih shtojcën 4), jo çdo orë mësimore fillon në kohë. Mësuesit humbin kohë edhe në korridor gjatë bisedave me kolegët duke shkuar në klasë. Në fakt do të ishte më e hijshme nëse mësuesi hy i pari në klasë ndërsa nxënësit pas tij. Kjo do të shmangte zhurmën që nxënësit bëjnë zakonisht kur mësuesi nuk është prezent. Kjo dukuri nuk është prezente në asnjë shkollë.

Ndërsa sa i përket të dytës, pra mobilizimit mendor, mësuesi duhet që të nxisë interesin te nxënësit, t'i ngacmojë ata duke i pyetur për diçka që kanë mësuar më parë, dhe në këtë formë kontrollon gatishmërinë e tyre për t'u kyçur në temë. Është e rëndësishme që mësuesi të qëndrojë në ballë të klasës dhe të flasë me zë të qartë, të përdorë kontaktin me sy dhe shikimin e vëmendshëm të nxënësve, për t'u siguruar se të gjithë e kanë vëmendjen te ai. Duke u bazuar në vëzhgimet e kryera në klasë, (shih shtojcën 4), që është forma më e mirë dhe më e lehtë për të parë se si aktualisht zhvillohet një orë mësimore, disa mësues të shkollave të analizuara fillojnë direkt me njësinë e re, pa mos e ndërlidhur me diçka konkrete apo me ndonjë njësi të mësuar më parë.

Një tjetër detaj i rëndësishëm janë kalimet e qeta, pra mësuesi duhet në mënyra të buta dhe pa u vënë re të kalojë nga një aktivitet në tjetër, pa mos shpërqëndruar nxënësit, të cilët çdoherë tentojnë të gjejnë hapësira të dalin nga tema dhe të diskutojnë diçka private apo jashtë teme.

Edhe përfundimi i mësimi është atribut që kërkon mjeshtri. Momentin që bie zilja, mësuesi duhet ta dijë se tek nxënësit nuk ka më mësim. Mësuesi duhet të programojë gjithë veprimtarinë kohore dhe të krijojë kështu hapësirë për zbatimin e të gjitha parashikimeve të tij. Ai nuk guxon as të përfundojë orën mësimore para se të vijë sinjali i ziles. Nëse njësia mësimore ka përfunduar pak minuta para se të bie zilja, siç ndodh në të shumtën e rasteve në klasat e vëzhguara, (shih shtojcën 4), ka mundësi që kjo hapësirë të përmbushet me një përsëritje, përmbledhje të njësisë së zhvilluar, duke i aktivizuar kështu të gjithë nxënësit.

Organizimi i punës në klasë

Me qëllim të mësimit sa më cilësor bëhet edhe organizimi i punës në klasë ku dallojmë disa lloje të organizimit apo mënyrës së uljes së nxënësve në klasë:¹

Organizimi frontal

Ky organizim ka karakter të organizimit të përbashkët me të gjithë nxënësit në kohë të njëjtë dhe ka karakter të punës kolektive. Meqë ecuria e punës mësimore zhvillohet kryesisht me një ritëm të përcaktuar, sipas një mesatareje të klasës (nxënësit mesatar), në këtë formë të punës mësimore duhet pasur parasysh edhe pozita e nxënësit mbi mesatar si edhe të atyre të cilët për shkaqe të veçanta ngecin. Prandaj, meqë është vështirë të bëhet angazhimi i veçantë i këtyre nxënësve, arsimtari shfrytëzon disa forma plotësuese mësimore ose jashtë-mësimore. Një nga dobësitë më karakteristike të kësaj forme kolektive është mungesa e komunikimeve reciproke (ndërmjet vetë nxënësve) meqë kryesisht komunikimet e tyre zhvillohen vetëm në relacion me mësimdhënësin. Për këtë dhe shkaqe të tjera mësimdhënësi gjatë punës mësimore është i detyruar që nxënësve nëpërmjet pyetjeve të zhvillojë komunikimin ndërmjet tyre, duke zhvilluar edhe raporte të ndryshme të socializimit në mësim (pyetje, kontrollime, korrigjime, biseda tematike etj.).

Puna në grupe

Meqë puna mësimore në grupe paraqet risi në pozitën e nxënësit dhe të arsimtarit në mësim, themi se shkalla e lartë e nxitjes së aktivitetit punues të nxënësve është karakteristikë e këtij formacioni social të organizimit të punës mësimore, që zakonisht vihet në shërbim të realizimit të detyrave të përgjithshme dhe të veçanta të bashkësisë së klasës si formë e veçantë e organizimit. Një ndër faktorët me rëndësi në organizimin e suksesshëm të formës mësimore në grupe janë përgatitjet paraprake që duhet zhvilluar. Nga përcaktimi i përmbajtjes së punës

¹ <https://edukimi.uni-gjk.org/upload/dokumentet/31943-Rilinda%20Dacaj%20.pdf> Vizituar më 15 janar, 2020.

mësimore, përkatësisht të veprimtarisë arsimore, varet kryesisht mënyra e përgatitjes organizative-operative dhe didaktike-metodike. Grupet optimale në këtë formë të organizimit të punës mësimore mund të jenë prej 3-6 nxënës.

Puna mësimore në çifte

Mund të themi se kjo formë është mjaft e pranishme edhe për përgatitjen e nxënësve si dhe për veprime të tjera mësimore. Kjo formë përdoret sidomos për zgjidhje të detyrave në matematikë, për ushtrimin e leximit të bukur, mësimin e gjuhëve të huaja, grumbullimin e materialit të shtjelluar më parë ose përgatitjen e mësimëve të reja. Meqë puna mësimore e çifteve zhvillohet kryesisht në mënyrë të pavarur, por edhe me ndihmën dhe udhëzimet e mësimdhënësit, konstatojmë se raportet e punës ndikojnë në mënyrë stimuluese mbi partnerët, dhe ka karakter të informimit rekuent, prandaj përgatitja e partnerit për punë është e domosdoshme. Por, megjithatë puna në çifte kërkon ndërrimin e shpeshtë të partnerëve, për të realizuar një socializim më të gjerë dhe njohje më të mirë të nxënësve. Në këtë variant të organizimit të punës mësimore të nxënësit ngrihet në shkallë të lartë përgjegjësia ndaj detyrave, pasi që nxënësit marrin vetëiniciativë për organizimin e tyre në mësim, duke zhvilluar edhe forma të ndryshme të marrëdhënieve interaktive (mësues-nxënës, nxënës-klasë, çift-mësues, çift-çift dhe çift-grupe të tjera mësimore).

Forma individuale - mësimi i individualizuar

Individualizmi, shikuar nga aspekti i tanishëm, krahas formave të tjera, paraqet, po ashtu, një nga elementet përbërëse edhe të zhvillimit bashkëkohor të veprimtarisë edukative dhe arsimore, sepse është gjithnjë në funksion të punës së pavarur të nxënësve dhe synon aftësimin e tyre për vetë-mësim dhe vetë-arsimim. Meqë tërë veprimtaria e punës mësimore individuale është e kushtëzuar nga faza përgatitore e nxënësve, për punë individuale, duhet cekur rolin dhe rëndësinë e nxitjes së lartë të aktivitetit të vetëdijshëm të nxënësve për këtë formë të organizimit të punës, si dhe përgjegjësinë e tij ndaj detyrave dhe obligimeve që rrjedhin nga

përmbajtja e punës individuale dhe e punës së pavarur. Nxënësve duhet t'u krijohen mundësi të ndryshme të komunikimeve reciproke, nëse ata nuk pengojnë punën e të tjerëve, gjithashtu, ndihma, kujdesi dhe mbikëqyrja e arsimtarit është më së e nevojshme, sidomos në fazën fillestare të punës në mësimin individual.

Nëse marrim për bazë vëzhgimet e realizuara në klasë, intervistat me mësimdhënësit si dhe rezultatet e nxënësve të anketuar në këto shkolla, (shih shtojcat 1, 2 dhe 4), mund të themi se nxënësit në klasë janë të ulur në grupe, por kjo nuk do të thotë se punojnë punë grupore, me disa përjashtime të vogla. Meqë puna në grupe është në modë në vendin tonë, mësimdhënësit tentojnë ta zbatojnë në klasë, por në mënyrë të gabuar duke e ngatërruar atë me organizimin frontal të punës në klasë.

Qëllimi dhe objektivat e klasës

Rreth qëllimeve dhe objektive të klasës (Brophy, 2003: 11) kritikon duke thënë “tekstet dhe mësuesit shpesh përqëndrohen aq shumë në përmbajtjen e lëndës, sa që harrojnë qëllimet dhe objektivat si dhe rezultatet që priten”. (Brophy, 2003: 28) pashtu shton “mësuesi duhet të formulojë dhe të transmetojë kërkesa që janë sa më pozitive që është e mundur, por duke mbetur gjithmonë realiste”. Mësuesi duhet të caktojë qëllimin dhe objektiva real, për të cilat në bashkëpunim me nxënësit duhet të punojë dhe t'i arrijë ato. Pra mësuesi duhet të vendosë edhe qëllim dhe objektiva për një orë mësimore, por edhe për një periudhë më të gjatë, si dhe vjetore.

Gjatë vitit shkollor, nxënësit, prindërit, dhe mësuesit takohen për të caktuar qëllime për kohë të shkurtër ose më të gjatë. Këto objektiva, si dhe rezultatet e pritura, janë të përcaktuara prej programit shkollor. Në të njëjtën kohë, duhet pasur kujdes dhe për objektivat individuale të cilat burojnë nga interesat, mundësitë dhe stilet individuale të nxënësve. Të tilla janë objektivat të

cilat janë të lidhura me planet për “zhvillim personal të nxënësit” të cilat shërbejnë si drejtime individuale për të nxënësit gjatë programit shkollor. Ghithashtu, ata drejtpërdrejt e përfshijnë familjen e nxënësit në procesin e edukimit të tij. Në fund të secilës periudhë në të cilën janë të përcaktuara objektiva të ndryshëm, nxënësit, familjet e tyre dhe mësuesit e vlerësojnë përparimin e nxënësve kah arritja e objektivave të përcaktuara. Arritja e qëllimeve të paravendosura duhet të shënohet, qëllimet të cilat nuk janë të realizuara duhet të rindërtohen dhe duhet të shtohen objektiva të tjera. Krijimi, monitorimi dhe evaluimi i këtij plani duhet të jetë fleksibil dhe në çdo kohë të jenë të disponueshëm për nxënësit. Planet e këtilla mund të quhen si rruga për arritjen e suksesit individual të nxënësit. Planet mirë të shkruara dhe të rregulluara bëhen instrument i vlefshëm për evaluimin e përparimit të nxënësit. (Walsh et al., 49).

Nga intervistat e kryera me disa kujdestarë klasash dhe mësimdhënës të shkollave të përfshira në punim, (shih shtojcën 1), mund të themi se ata kryesisht vendosin qëllime dhe objektiva dhe mundohen që t’i arrijnë ato bashkë me nxënësit. Ndërsa sa i përket përfshirjes së prindërve në shkollë, siç mund të kuptohet nga intervistat e kryera me mësimdhënësit dhe nga anketimi i prindërve, (shih shtojcën 1 dhe 3), prania e prindërve edhe pse nuk mohohet, nuk është e përfshirë aq sa duhet apo nuk janë mjaftueshëm në rrjedha dhe të informuar me qëllimet apo objektivat e vendosura.

Klima

Klimën e klasës (Musai, 2003: 240) e definojnë si “mjedisi i krijuar nga mësuesi, që synon të motivojë nxënësit në qëndrimin e tyre aktiv ndaj të nxënësve”. Pra një klimë pozitive lehtëson të nxënësve dhe mban të motivuar nxënësit. Sa i përket motivimit, ai është një temë më vete, por ne do të cekim shkurt se motivimi është thelbësor për të punuar dhe arritur sukses, është forca që nxënësve të ngulin këmbë dhe ta realizojnë qëllimin. Dhe pikërisht siç përmendëm edhe më lart, është mësuesi ai që tërheq nxënësit në këtë drejtim, madje kemi shumë raste ku një nxënës zgjedh të studiojë një drejtim të caktuar, vetëm pse dikur ka patur një mësues të asaj fushe, i cili e ka motivuar deri në atë pikë, sa që ai gjithmonë do të ketë besim se është i aftë ta kryej me sukses atë që ka filluar. Mirëpo mund të kemi edhe ngecje, meqë në shkollë mësohen shumë gjëra që janë jashtë interesit të nxënësve dhe aq abstrakte sa do ta lodhnin edhe një të rritur dhe që të njëjtat nuk hyjnë në punë as në jetën e përditshme.

Klima pozitive në klasë sipas (Walsh et al., 58) ndërtohet me:

- Krijim i atmosferës së besueshmërisë
- Ndjenjë për përkatësi në bashkësi
- Përfshirjen e nxënësve në marrjen e vendimeve
- Sjellje të mirë dhe nxitje
- Energji pozitive dhe entuziazëm nga ana e mësuesit
- Përcaktim i pritjeve të qarta nga rezultatet për të nxënësve
- Pjesëmarrje të drejtë dhe të barabartë.

Në klasat e analizuar të shkollave fillore të përfshira në studim, nga metodat e aplikuara të kërkimit mund të konstatohet se ekziston një klimë mesatare në klasë, gjë e cila dëshmon se duhet edhe më shumë punë si nga ana e mësuesit ashtu edhe nga ana e nxënësve, për ta mbajtur në nivel të njëjtë.

Nxitja e mendimit tek nxënësit

*"Mos i trajtoni nxënësit të mësojnë me forcë dhe ashpërsi, por drejtoni duke argëtuar mendjen e tyre, në mënyrë që të keni mundësi me saktësi të zbuloni aftësitë dhe gjenialitetin e secilit". **Platoni.***

Kuptohet që roli më i rëndësishëm për të zgjuar tek nxënësit dëshirën për të qenë kritik dhe krijues, i takon shkollës dhe veçanërisht mësuesit. Ai duhet të jetë bashkëpunëtor, që jo vetëm të transmetojë njohuritë, por të ndihmojë nxënësit t'i përvetësojnë ato nëpërmjet një pune këmbëngulëse krijuese dhe kërkimore. Mësuesi më i mirë është ai që nuk kufizohet thjeshtë në përgatitjen profesionale, por që nxit, frymëzon dhe motivon nxënësin të zhvillojë dhe zbulojë inteligjencën e tij, të jetë aktiv dhe të kultivojë në vetvete vlerat njerëzore universale. Nxënësit në moshën kur shkojnë në shkollë sidomos në moshën më të hershme janë kurioz dhe të prirur për të krijuar, kështu që mësuesi duhet të punojë në këtë drejtim duke i nxitur, mbështetur dhe motivuar nxënësit, për të cilët kjo është e rëndësishme jo vetëm gjatë periudhës së shkollës, por edhe për gjithë jetën. Mësuesi duhet të tregojë respekt ndaj fëmijëve, me të cilin shprehin interes për ndjenjat, idetë dhe eksperiencën e tyre. Ai duhet të sjellë në klasë materialin e nevojshëm, pastaj të paraqesë përvoja të ndryshme rreth objektit mësimor, më tej t'i kërkohet fëmijës të shkojë përtej të dhënave me qëllim që të nxitet për ide të reja.

Nuk mjafton që nxënësi vetëm të mësojë përmendësh materialin e servuar dhe t'u përgjigjet pyetjeve të mësuesit, por duhet edhe të prodhojë nga të nxënëti aktiv, pasi që kjo është edhe tendenca e vendeve të zhvilluara dhe kërkesa globale. Sigurisht që në procesin e krijimit rol të rëndësishëm përveç imagjinatës, ka edhe arsya. Është provuar se fëmijët janë shumë të prirur për të krijuar ide. Vetëm se atyre duhet t'u krijohet klima e favorshme. Pa zhvillimin e mendimit kritik dhe problemor në fillim nuk kalohet te mendimi krijues, pasi ai sipas Taksonomisë së rishikuar të Bloom-it është niveli më i lartë që mund ta posedojë një person. Mësuesi duhet që t'i nxisë nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike dhe ta pasqyrojnë këtë në veprat e tyre, duke e lidhur diturinë e mëparshme me të renë. Ai poashtu duhet t'u parashtrojë situata ku ata të mundohen të zgjedhin probleme në mënyrë origjinale dhe të gjejnë zgjidhje alternative për problemet të cilat do t'ju paraqiten, duke e kuptuar problemin si mundësi për zbulim. Në këtë

mënyrë nxënësit do të vërejnë dhe zhvillojnë aftësi me të cilat do t'i përcjellin vëzhgimet dhe idetë e tyre. Mëvetësia dhe iniciativa janë faktorë motivues në të lidhurit individuale të ideve dhe përvojave. Nxënësit të cilët parashtrojnë pyetje dhe pastaj mundohen vetë t'i gjejnë përgjigjet, marrin pjesë në të nxëniet e tyre dhe janë të aftë për të zhgjedhur probleme. (Walsh et al.).

Sipas (Musai, 2003: 100) "të nxënët i referohet një veprimi të brendshëm që ndodh në kokat e nxënësve, si rezultat i veprimeve të jashtme të mësimdhënies". Mirëpo disa mësues bëjnë vetëm minimumin e kërkuar, ndërkaq mësuesit e mirë punojnë pa u lodhur për të krijuar një mjedis afeksionues dhe edukues për nxënësit e tyre. Besimi ndaj mësuesit nxit ndjenjë sigurie, që si rrjedhojë i jep atij besimin që t'i ndihmojë në minimizimin e gabimeve dhe maksimizimin e përparimit. Këtë përparësi mësimdhënësit duhet ta shfrytëzojnë dhe t'u ndihmojnë fëmijëve apo nxënësve të krijojnë gjëra të reja, siç thotë edhe Zhan Piazhe: *"Qëllimi kryesor i arsimit është që të krijojmë njerëz, të cilët janë të aftë të bëjnë gjëra të reja, jo thjeshtë ta përsërisin atë që e kanë bërë brezat tjerë, njerëz që janë krijues, shpikës dhe zbulues"*.

Sipas (Walsh et al., 40-41), shkollat duhet t'i drejtojnë nxënësit të zhvillojnë pesë tipare shumë të rëndësishme për shekullin XXI:

1. Kreativitet
2. Produktivitet
3. Kuriozitet
4. Bashkëpunim
5. Empati.

Rol të rëndësishëm për zhvillimin e mendimit të nxënësit kanë edhe aktivitetet e lira. Për të njëjtat (Veseli, 1987: 146) shtjellon se "duke u bazuar në thelbin, rolin dhe vendimin që zënë aktivitetet e lira, në procesin edukativo-arsimor, aktivitetet e lira duhet patjetër që t'ia mundësojnë çdo fëmije të shprehet lirisht, lirisht të kërkojë dhe zbulojë diçka, pastaj lirisht të krijojë, luajë, dhe lirisht të bashkohet dhe shoqërohet me shokët tjerë në aktivitetet e lira.

Kësisoji fëmija do të ketë mundësi që të verifikojë dhe vërtetojë mundësitë dhe aftësitë e veta, e kësisoji të lirohet nga predionet dhe detyrimet e të rriturve”.

Nxënësve u duhen mundësi që ta zhvillojnë inteligjencën dhe talentin të cilin e kanë. Vendi më i mirë për t’i mundësuar këto kushte është mjedisi natyror për mësim, prandaj edhe klasa duhet të duket ashtu. Në vitin 1984, Hauard Gardner, profesori i univertzitetit të Harvardit ka thënë se kultura e përcakton inteligjencën tepër ngushtë. Sipas kësaj, inteligjenca duhet ta humbë mistikën e saj dhe të bëhet funksionale.

Rreth temës së gjerë që u shtjellua më lart, studimi i kryer nëpërmetj metodave cilësore, sasimore, dhe të vëzhgimit, (shih shtojcën 1, 2, 3 dhe 4), tregon se në shkollë apo më saktësisht në klasë edhe përkundër pohimeve të mësimdhënësve se i kushtohet rëndësi mendimit të nxënësve, nuk tingëllon aq bindshëm nga ana e nxënësve dhe prindërve realizimi në praktikë. Poashtu mund të konkludojmë se në këto shkolla nuk nxitet mendimi kritik dhe problemor aq sa duhet si dhe nuk i kushtohet aq shumë vëmendje mendimit krijues apo krijimtarisë së nxënësve. Ndodh që në një klasë të ketë disa talentë dhe mësimdhënësit as që janë të vetëdijshëm për këtë, e lëre më për t’i përkrahur e motivuar më tej.

Shprehje me përkrahje pozitive dhe negative të mendimit të lirë në klasë

| PËRKRAHJE NEGATIVE | PËRKRAHJE POZITIVE |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> ● Ku e gjete këtë budallallëk? ● Mos bë pyetje të tilla idiote! ● Nuk bën dot një herë një gjë tamam? ● Sillu siç duhet për moshën tënde! ● S'ka për të qenë kaq e lehtë sa e mendon ti! ● Si nuk mendove njëherë! ● A kaq mund të thuash për këtë? ● Sa herë duhet të të them?! ● A ke dëgjuar ndonjëherë që kjo të bëhet kështu? ● Pse nuk mendon para se të flasësh? | <ul style="list-style-type: none"> ● Dije interesante! ● Më trego për të, të lutem! ● Si e arrite këtë përfundim? ● Gjë e mirë që e ke menduar të gjithë vetë! ● A ke menduar për alternativa të tjera? ● Çfarëdo mendimi të marrësh, nuk ka problem për mua! ● Përpiqu vetë njëherë, në qoftë se ke nevojë, më thuaj. ● Ja një ide imagjinative. ● Pyetje e mirë. ● Jam i sigurt që ke për ta bërë mirë. |

Tabela 1. Shprehje me përkrahje pozitive dhe negative të mendimit të lirë në klasë.²

² Zajazi, T. (2003). *Metodologji e mësimdhënies dhe mësimnxënies*. Shkup: Vinsent Graphic. fq. 448.

Bashkëpunimi dhe vendosja e rregullave në klasë

Ekzistojnë dy qëllime kryesore nga ana e mësimitdhënësit për menaxhimin e klasës:

1. Të nxisë përfshirjen dhe bashkëpunimin e nxënësve në të gjitha aktivitetet e klasës
2. Të krijojë një mjedis pune produktiv.

Pa bashkëpunimin e të gjithë anëtareve të një grupi, asnjëherë s'mund të themi se kemi një grup apo një klasë të shëndoshë. Edhe kur disa nxënës nuk marrin pjesë, ata duhet të mos i pengojnë të tjerët të bëjnë një gjë të tillë. Njëra nga detyrat e mësuesit është që të sigurojë bashkëpunimin e nxënësve në veprimtaritë e klasës. Të tërheqësh bashkëpunimin e nxënësve do të thotë shumë më tepër sesa të merresh në mënyrë efektive me çrregullimet në sjellje. Një gjë e tillë do të thotë të planifikosh veprimtari, të bësh gati materialet, t'i japësh nxënësit kërkesat dhe detyrat e duhura mësimore dhe të sjelljes, t'i parashikosh problemet dhe t'i ndalosh ato përpara se të nisen, të përzgjedhësh dhe të ndjekësh veprimtaritë në mënyrë që të mbash rregullin dhe ecurinë normale. Sipas (Anderson & Spaulding, 2007: 16) "rregullat e klasës janë shpesh hapi i parë i një mësuesi në menaxhimin e klasës. Mësuesi duhet të vendosë se kush do t'i bëjë rregullat dhe se si ato do të mësohen nga nxënësit, ndërsa gjithashtu duke marrë parasysh edhe se si rregullat do të perceptohen nga nxënësit". Pra me fjalë të tjera, nxënësit më mirë do të mbajnë mend dhe do të respektojnë rregulla që janë vendosur nga vetë ata, se sa vetëm nga ana e mësuesit.

Në artikullin e publikuar në "Portalin shkollor Albas", (Bebi, 2017) ka shënuar: "në klasë duhet të vihen rregulla që nxënësit janë të gatshëm t'i zbatojnë, sepse ndonjëherë sjellja e nxënësve ndryshon për shkak të aktivitetit që zhvillohet në klasë, apo lënies së nxënësit jashtë vëmendjes, gjë që mund të sjellë edhe probleme. Në klasë ka një disiplinë të mirë kur aktivitetet janë të strukturuar për të përmirësuar sjelljen bashkëpunuese të nxënësve."³

Për të krijuar një rregullore siç thamë edhe më lart, duhet që ajo të jetë e krijuar nga të gjithë. Për të arritur përfshirjen e nxënësve, duhet që secili prej tyre të mendojë diçka dhe të dalë ta

³ Bebi, Xh. (2017). "Portali shkollor Albas", në <http://www.portalishkollor.al/kuriozitet/mesimdhenia-eshte-art-dhe-te-tille-e-ben-vetem-mesuesi> Vizituar më 25 dhjetor, 2019.

shkruajë atë në një hamer, i cili do të qëndrojë në një vend të dukshëm, që rregullat të rikujtohen. Rregullat duhet të përcaktohen në formë pozitive dhe jo negative, të jenë të lehta për t'u mbajtur mend, të jenë të qarta dhe të jenë në lidhje me sjelljen e jo me procedurat. Nxënësit, gjithashtu, duhet vetë të vendosin se cilat do të jenë pasojat për atë që nuk do t'i respektojë rregullat të sjellura në mënyrë të përbashkët.

Ja edhe disa këshilla sipas (Walsh et al.), që mund t'u përmbahet mësuesi për një klasë më të mirë:

1. Çdoherë kur është e mundur, angazhoni fëmijët në krijimin e rregullave në lidhje me sjelljen e tyre dhe pjesëmarrjen në mësim
2. Krijoni kushte në të cilat do reflektohet praktika demokratike
3. Vazhdimisht gjeni mënyrë adekuate që ta stimuloni vetërregullimin dhe pavarësinë tek fëmijët
4. Drejtoni në drejtim pozitiv sjelljen e fëmijëve, duke e pasur parasysh personalitetin e secilit fëmijë dhe nivelin e zhvillimit të tij.

Në klasë nuk është aspak për tu habitur kur shfaqen edhe situata të paparashikuara, kështu që mësuesi duhet të jetë fleksibil dhe i gatshëm të zgjedhë edhe ato probleme që janë shfaqur në moment, përveç atyre që ka planifikuar. Për mësuesin këto janë probleme të zakonshme, por ndonjëherë mund të shfaqen edhe probleme të një natyre më serioze, ku mund të alterohet situata dhe mund dikush të përfundojë i ofenduar, si dhe të ngjallet urrejtje. Edhe në këto raste, mësuesi është ai që duhet ta zbusë diskutimin për të mos pasur pasoja të mëtejme.

Rregulla disiplinore

Sipas (Brophy, 2003: 9) "mësuesit e suksesshëm nuk kanë nevojë që të merren për shumë kohë me probleme të sjelljes sepse ata përdorin teknika të tilla drejtimi që nxisin bashkëpunimin mes nxënësve dhe përkrahin pjesëmarrjen e tyre në aktivitete". Prandaj mësuesit duhet ta shfrytëzojnë kohën në mënyrë efektive dhe produktive duke pasur në fokus përmbushjen e

objektivave se sa gjatë gjithë kohës të diskutojnë rreth disiplinës dhe asaj se çfarë nuk duhet bërë në klasë. Nga ana tjetër (Willower, Eidell, & Hoy, 1973: 42) potencojnë se “fokusi është që të krijohet një atmosferë pozitive dhe mbështetëse për të nxitur kështu fuqinë e nxënësit. Theksi vihet te vetë disiplinimi, pra nxënësit kanë përgjegjësi për veprimet e tyre. Nxënësit mund të shfaqin pikëpamjen e tyre, kështu mund të kujdesen për nevojat e tyre”.

Një fakt interesant është se në shkollat japoneze, nxënësve nuk u jepet asnjë lloj testi deri sa arrijne klasën e katërt, sepse objektivi për vitet e para të shkollës nuk është për të gjykuar aftësitë e fëmijëve për të mësuar, por për të zhvilluar sjellje të mirë dhe karakter. Mësuesit japonez ua mësojnë fëmijëve sjelljen e mirë para njohurive. Poashtu nuk punësohet kujdestarë apo roje në shkollë, por inkurajojnë nxënësit që vetë ta pastrojnë shkollën pasi sipas Sistemit arsimor japonez, kjo i mëson të kenë respekt, përgjegjësi dhe barazi.

Disa rregulla të sjelljes:

- Dëgjo me vëmendje!
- Zbato detyrat!
- Bëhu shok i mirë!
- Sillu me kulturë!
- Leri gjërat në vendin e vet!
- Ngreje dorën për të marrë fjalë!

“Shpesh herë mësuesit përdorin edhe mënyrën e dënimit, por duhet pasur parasysh se përdorimi i shpeshtë i dënimit është dukuri që ndodh në rastet e menaxhimit të dobët të klasës dhe, në përgjithësi, duhet shmangur. Në rastet që jepet dënim, ky dënim patjetër duhet të lidhet me sjelljen e keqe. Dënimet më të buta janë shpesh më efektive dhe nuk sjellin emocione negative. Nxënësi do të bëjë më pak gabime nëse ai përfshihet në aktivitetet që i dëshiron. Ndërsa për rastet më të rënda si: zënie mes shokësh në klasë, ndërprerja e vazhdueshme e mësimit, vjedhjet, etj., kërkojnë masa disiplinore nga bordi i shkollës. Megjithatë, edhe këto raste një mësues i aftë di si t’i menaxhojë dhe t’i minimizojë. Në rastet e dënimit marrja

parasysh e pasojave është faktor kyç në menaxhimin e klasës” (Bebi, 2017). “Dënimi, nga ana tjetër, ka natyrë ndëshkuese. Ai nuk shërben domosdoshmërisht për të mësuar, por përkundrazi bëhet më keq. Fëmijët janë në shkollë për të mësuar dhe kjo përfshin edhe gabimet që mund të bëjnë”.⁴

Le të kthehem te hulumtimi ynë konkret dhe të shohim se në shkollat e analizuara a vendosen rregulla në klasë dhe kush i vendos ata, pra të shohim se a ekziston bashkëpunim ndërmjet mësuesit dhe nxënësve. Nga pikëpamja e mësimdhënësve, (shih shtojcën 1), rregullat e përgjithshme dhe disiplinore në klasë vendosen bashkë me nxënësit, ndërkaq nga këndvështrimi i nxënësve, (shih shtojcën 2), ata vendosen edhe në mënyrë të përbaskët, por edhe nga vetë mësuesi.

⁴https://www.cfo-pso.org.ph/pdf/10thconferencepresentation/1_Effective_Classroom_Management-Dr_Calderon.pdf Vizituar më 8 janar, 2020.

Klasa e shek. XXI

Klasa përfaqëson element parësor, pedagogjik dhe hapësinor të shkollës. Si element themelor të secilit institucion arsimor, ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe për shkak se procesi i edukimit të njeriut, përkatësisht arsimit dhe edukimit i tij në një formë të organizuar fillon pikërisht në klasë.

Secila klasë karakterizohet me:

- Orar kohor të përgatitur mirë
- Strukturë të mirë organizuese
- Ambient të këndshëm
- Klimë pozitive pune
- Materiale didaktike dhe të shpenzueshme.

Me vetë faktin se klasa duhet të jetë sa më efektive dhe produktive, cilësitë dhe karakteristikat të cilat e determinojnë klasën si bashkëkohore janë me më shumë rëndësi. Klasa e shekullit XXI është klasë në qendër të së cilës janë nxënësit dhe aspektet e tyre të ndryshme të zhvillimit, nevojat personale, tempoja e zhvillimit dhe stilet e ndryshme të të nxënësve. Programi i cili realizohet në klasën bashkëkohore është fleksibil dhe i adaptueshëm sipas nevojave konkrete të nxënësve, që niset nga interesat e tyre. Suksesi i nxënësve ndiqet vazhdimisht dhe përdoren modele vlerësimi më të ndryshme. Në klasën e shekullit XXI, prindërit, përkatësisht familjet, ndihen si partnerë të cilët gjithashtu marrin pjesë në suksesin e ardhshëm të nxënësve. Duhet pasur parasysh se një klasë nuk mund të ngrihet në nivelin e një klase bashkëkohore pa udhëheqje dhe koordinim të mirë nga ana e mësuesit, i cili si udhëheqës “i padukshëm” dhe menaxher që i nxit nxënësit dhe u ofron burime dhe mundësi të ndryshme për të nxënësit. Mësuesi duhet t’i ndjekë prirjet e reja në arsim edhe të krijojë ndryshime në klasë. Klasa, si element themelor për realizim të procesit edukativo-arsimor, është një sistem organizues i ndërlikuar, kompleks dhe i hapur. Qëllimi dhe detyra kryesore e dimensioneve pedagogjike është të mundësojë aktivitete të cilat do të kontribuojnë për arritje dhe rezultate të larta të

nxënësve. Klasa e shekullit XXI duhet të jetë ambient dinamik dhe i ndryshueshëm, i plotësuar me materiale interesante dhe interaktive të cilat u përshtaten fazave të intereseve dhe zhvillimit individual të fëmijëve.

Më përpara gjatë orës ka dominuar mësuesi, i cili e ka dhënë mësimin, kurse nxënësit kanë degjuar ose e kanë shkruar atë që mësuesi ka shënuar në dërrasë. Ndërsa tani fëmija ndodhet në qendër të procesit të të nxënësve, kurse mësuesit krijojnë mjedis, i cili e reflekton këtë perspektivë. Në klasën e shekullit XXI është me rëndësi vendi të shfrytëzohet në mënyrë kreative dhe racionale. Këtu dominojnë punime të nxënësve që e reflektojnë atë të cilën nxënësit e punojnë në atë periudhë si për shembull postere që në mënyrë piktoreske e plotësojnë atë, e cila punohet sipas programit mësimor ose e cila u ndihmon nxënësve ta zmadhojnë diturinë e tyre. Prej nxënësve pritet të jenë të ndërgjegjshëm jo vetëm për mësimet e veta, por edhe për ambientin në të cilin e kalojnë pjesën më të madhe të ditës dhe prandaj duhet edhe ata të marrin pjesë në krijimin e klasës (Walsh et al.)

Nëse krahasojmë klasën e shek. XXI dhe klasat tona të hulumtuara nëpërmjet metodës së vëzhgimit dhe metodave kualitative dhe kuantitative, (shih shtojcën 1, 2, 3 dhe 4), dallojmë se jo çdoherë në qendër vendoset nxënësi dhe nevojat personale të tij, programi i cili realizohet në klasë nuk është fleksibil dhe i adaptueshëm sipas nevojave konkrete të nxënësve, që niset nga interesat e tyre, prindërit nuk janë të përfshirë aq sa duhet, mësuesi nuk i ndjek mjaftueshëm prirjet e reja në arsim që të krijojë ndryshime në klasë, nuk posedohet me materiale të mjaftueshme interesante dhe interaktive të cilat u përshtaten fazave të intereseve dhe zhvillimit individual të fëmijëve dhe për një përfundim modest, në muret e klasave të hulumtuara kryesisht vërehen punime të nxënësve apo postere, të cilët përmes formës vizuale që ofrojnë, ua lehtësojnë memorizimin nxënësve dhe zmadhojnë diturinë e tyre.

Klasa tradicionale dhe klasa e shekullit XXI

Në vijim janë paraqitur karakteristikat e klasës tradicionale dhe asaj moderne.

| Klasa tradicionale | Klasa e shekullit XXI |
|--|--|
| <p>Shkolla është detyrim i cili duhet të realizohet.</p> <p>Nxënësit i pranojnë të gjitha informacionet në mënyrë pasive dhe e pranojnë autoritetin e mësuesit.</p> <p>Programi mësimor është prezantuar nëpër përmbajtja të zgjedhura mësimore.</p> <p>Programi mësimor është përcaktuar dhe zhvilluar nga ekspertët e jashtëm.</p> <p>Marrja e vendimeve është me karakter hierarkik.</p> <p>Përmbajtja mësimore është dizajnuar në përkrahje të pritjeve tradicionale të lidhura me sjelljen sociale dhe arritjet akademike.</p> <p>Aktivitetet bazohen mbi librin ose fletoren e punës.</p> <p>Theksi vihet mbi zotërimin e aftësive themelore.</p> <p>Mësuesit janë burim i vetëm informacionesh.</p> <p>Konsiderohet se mësuesit janë njerëz të cilët e kanë kryer të nxënësit të tyre.</p> <p>Mësuesit i prezantojnë informacionet e tyre përmes ligjeratave, fletoreve të punës dhe fletëve punuese.</p> | <p>Arsimi është sfidë dhe zbavitje.</p> <p>Nxënësit janë involvuar në mënyrë aktive në zgjidhjen e problemeve dhe në planifikimin e aktiviteteve të ardhshme.</p> <p>Përmbajtja mësimore është e integruar dhe fëmijët bashkëpunojnë.</p> <p>Përmbajtja mësimore varet nga dëshirat dhe interesat e fëmijëve.</p> <p>Vendimet merren në mënyrë të përbashkët.</p> <p>Programi mësimor është krijuar ashtu që u përshtatet potencialeve individuale të fëmijëve edhe krijon marrëdhënie pozitive kah të nxënësit.</p> <p>Aktivitetet bazohen mbi burime të ndryshme informatash.</p> <p>Theksi vihet mbi kuptimin e koncepteve të rëndësishme.</p> <p>Mësuesit janë lehtësues dhe udhëheqës në procesin e të nxënësit.</p> <p>Mësuesit shikojnë vetveten si nxënës bashkë me fëmijët e tjerë.</p> <p>Mësuesit krijojnë situata për të nxënësit duke i bazuar mbi përvoja të drejtpërdrejta, interaksion social dhe hulumtime.</p> |

| | |
|--|--|
| <p>Teknikat për kontrollim të diturisë, të cilat i përdorin mësuesit, fokusohen mbi përgjigje me “e saktë / e pasaktë” ose pyetje të mbyllura.</p> <p>Mësuesit janë përgjegjës për sjelljen në klasë dhe janë konsideruar për autoritet.</p> <p>Mësuesit zakonisht u japin nxënësve informacione.</p> <p>Nxënësit më shpesh punojnë vetë.</p> <p>Komunikimi me familjen zakonisht realizohet në rast të problemeve.</p> <p>Dihet me saktësi kur do të kryhet evaluimi gjatë gjithë vitit.</p> <p>Nota merret në bazë të vetëm një kontrollimi të diturisë.</p> | <p>Mësuesit e nxitojnë të menduarit kritik tek nxënësit me pyetje të hapura.</p> <p>Mësuesit dhe nxënësit bashkë përcaktojnë rregulla për sjellje me të cilën theksohet përgjegjësia personale.</p> <p>Mësuesit sillen në mënyrë interaktive, duke marrë rol mediator.</p> <p>Nxënësit punojnë në çifte ose grupe të vogla.</p> <p>Komunikimi me familjen fillon që ditën e parë shkollore dhe fokusohet mbi përcaktimin dhe planifikimin e qëllimeve të përbashkët për secilin fëmijë veçanërisht.</p> <p>Vlerësimi është i vazhdueshëm dhe kumulativ.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar varet nga shumë gjëra.</p> |
|--|--|

Tabela 2. Karakteristikat e klasës tradicionale dhe asaj moderne.⁵

⁵Walsh, K. B., Kiranxhiska, S., & Gjorgjieva, T. Ll. *Doracak: Krijimi i mjedisit për të nxënësit për shekullin XXI*. USAID & AED. Shkup: Shën Kliment Ohridski. Vizituar më 4 janar, 2020.
https://www.stepbystep.org.mk/WEBprostor/Krijimi_i_mjedisit_p%C3%ABr_t%C3%ABnx%C3%ABnit_p%C3%ABr_shekullin_XXI.pdf fq.21-25.

Mësuesi i mirë

Në artikullin e botuar në portal, (Bebi, 2017) shkruan: “mësimdhënia është art dhe të tillë e bën vetëm mësuesi. Vetë mësuesi duhet të jetë i qartë se çfarë do të kërkojë nga nxënësit dhe t’u tregojë nxënësve se çfarë kërkon nga ata”. Nxënësit që kanë marrëdhënie të mira me mësuesin pranojnë më me lehtësi rregullat, procedurat dhe veprimet disiplinore.⁶ Ndërkaq (Nushi, 1999: 122) shprehet “arsimtarët kanë për qëllim realizimin e detyrave edukative dhe arsimore që janë në programet e tyre dhe ata duhet të jenë të zhveshur nga qëndrimet subjektive ndaj nxënësve. Në shkollë fëmija fillon ta identifikojë veten me arsimtarët, të cilët janë modele të sjelljes dhe aktiviteteve të gjithmbarëshme të secilit nxënës. Pikërisht për këtë arsye, arsimtari ka rëndësi shumë të madhe, ndoshta dhe vendimtare për formimin e personalitetit të fëmijëve”. Përveç mësimdhënies, mësuesi duhet të jetë shumë i përkushtuar edhe nga ana tjetër me nxënësit, sidomos kur janë në vitet më të hershme, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e tyre të lartë, në të cilën mësuesi dhe sjellja e tij ndikon jashtë mase të ata. (Cummings, 2000: 14) konkludon se “nxënësit kanë nevojë për hero, me të cilët mund të afrohen dhe ky hero mund të jetë mësuesi”.

Menaxher i mirë është ai që di t’i delegojë punët, meqë një njeri nuk mundet t’i bëjë të gjitha. Në rastin tonë menaxher i klasës është vetë mësuesi apo kujdestari i klasës, i cili duhet të mbajë rend dhe evidencë për të gjitha gjërat. Për të pasur një lehtësim në punën e tij, ai duhet që nxënësve t’u ndajë detyra të caktuara, gjë e cila përveç se ndihmon në mirëmbajtjen e klasës, përfshin edhe më tepër nxënësit, i bën të ndjehen më të vlefshëm dhe në njëfarë mënyrë zgjon interesin te ata për të qenë udhëheqës të ardhshëm. Për veprime të këtilla apo të ngjashme mësimdhënësi në fillim duhet që ta njohë klasën, më saktësisht t’i njohë nxënësit e vet. Rreth kësaj (Williams, 2009: 31) thotë “ne duhet ta njohim mirë nxënësin, t’i njohim talentet e tij madje edhe jashtë klasës, të kemi njohuri për rrethanat, kërkesat, qëllimet dhe të ardhmen e tij. Me flajë të tjera, ne duhet të dijmë se çfarë përvojash kanë përjetuar ato, kush janë, dhe çka duan të bëhen”. Nga kjo mund të shohim se mësuesi përveç lidhjes dhe afërsisë që krijon me

⁶https://www.cfo-pso.org.ph/pdf/10thconferencepresentation/1_Effective_Classroom_Management-Dr_Calderon.pdf Vizituar më 8 janar, 2020.

nxënësit, duhet të ketë marrëdhënie të ngushta edhe me prindërit, pasi ata përbëjnë një urë nga ku mund të merren të dhëna për çdo nxënës. Në ndërkohë (Popp, 2017: 323) sugjeron “ndihmoni nxënësit tuaj të ndajnë atë që kanë mësuar në shkollë dhe të ndërtojnë lidhje me përvojat e familjeve të tyre duke u kërkuar atyre të vizatojnë ose të shkruajnë diçka që kanë mësuar në fund të një dite në shkollë”. (Demiri & Jankova, 14) nga kërkimet nëpër shkolla bijnë në përfundim se “arsimtarët bisedojnë më tepër se nxënësit, vajzat më shumë se djemtë. Kërkimet nga përvojat e fituara nëpër shkolla, tregojnë se arsimtarët, në orët e mësimin flasin më shumë, ndërsa nxënësit më pak. Bisedat e nxënësve shpeshherë bëhen me dominimin e disave dhe disa nxënës mund ta mbarojnë shkollimin e tyre pa thënë asnjë fjalë para ndonjë arsimtari”.

(Demiri & Jankova, 15) poashtu potencojnë se “nëse arsimtarët duan t’u ndihmojnë nxënësve që t’i harrojnë problemet, nuk është adekuate që t’i bëjnë fëmijët të ‘disponohen dhe të harrojnë për streset’. Arsimtari duhet t’i njohë shkathtësitë e dëgjimit dhe reagimit, të jetë i ndershëm dhe me seriozitet t’i rreket zgjedhjes së problemit të nxënësit”. Nxitja e të gjithë arsimtarëve për të mësuar shkathtësitë për dëgjim dhe të njejtat t’i përdorin me qëllim, që vërtetë t’i dëgjojnë nxënësit, si dhe të dëgohen njëri me tjetrin, do të kishte sjellë shumë përmirësime shëndetësore, mentale dhe emocionale në të gjitha shkollat në vend. Ajo mund t’u ndihmojë nxënësve t’i zbulojnë, kuptojnë dhe të mësojnë për problemet e tyre dhe të ballafaqohen me to.

Duke u bazuar në kërkimet rreth mësimdhënësve nëpërmjet qëndrimit të përgjigjeve të tyre si dhe duke marrë parasysh edhe rezultatet e përgjithshme të pyetësorëve dhe vëzhgimet në orët mësimore, (shih shtojcën 1, 2, 3 dhe 4) mund të konstatohet se asgjë s’është e rëndë nëse mësuesi është i mirë. Marrëdhëniet e mira me mësuesin si nga ana e nxënësve ashtu edhe nga ana e prindërve e lehtësojnë të gjithë procesin. Secili mësues mundohet të jetë i përkushtuar në mënyrën e vet dhe tenton të krijojë një urë me prindërit për të patur një sukses të përbashkët.

Vetitë dhe karakteristikat e mësuesit të mirë

Mësuesi gjithmonë duhet të shprehë gadishmëri, vullnet dhe durim për punët e shumëfishta në klasë. Ai poashtu duhet të shfaqë interesim, sinjeritet dhe kënaqësi gjatë orës mësimore, gjë që ndikon në përfshirjen e nxënësve në çdo aktivitet. (Brophy, 2003: 8) për mësuesit thotë “mësuesve u duhet të manifestojnë cilësi personale të tilla që të jenë shembuj dhe modele shoqërizimi të vërtetë”. Mësimdhënësit duhet të jenë më të ngrohtë, më të qetë, të aftë për të parashikuar reagimet e nxënësve, analitik, të balancuar, inspirues, të gatshëm për të dhënë kontribut personal, të posedojnë intuitë të lartë, mos vërehen se kontrollojnë gjithçka etj.⁷

(Musai, 2003: 209) numëron disa veti të mësuesit bashkëkohor:

1. Të jenë më të sigurt, më të përzemërt dhe më të shoqërueshëm
2. Të veprojnë si biznesmenë
3. Të jenë më nxitës
4. Të përdorin më shumë kontaktin me sy
5. Të përdorin më shumë humorin
6. Të jenë më të qartë rreth rregullave të klasës së tyre.

Në vijim janë paraqitur karakteristika të një mësuesi të mirë.⁸

1. *Një mësues i mirë i respekton nxënësit e tij* - Në një klasë të një mësuesi të mirë, idetë dhe mendimet e secilit person vlerësohen. Nxënësit ndjehen të sigurt për të shprehur ndjenjat e tyre dhe mësojnë të respektojnë dhe të dëgjojnë të tjerët.
2. *Një mësues i mirë krijon ndjenjën e bashkësisë dhe përfshirjes në klasë* - Respekti i ndërsjellë në klasën e këtij mësuesi siguron një mjedis mbështetës dhe bashkëpunues. Në këtë komunitet të vogël, ka rregulla që duhet të ndiqen, punët duhet të bëhen dhe secili nxënës është i vetëdijshëm se ai ose ajo është një pjesë e rëndësishme e grupit. Ai u ofron nxënësve ndjenjën

⁷ https://www.cfo-pso.org.ph/pdf/10thconferencepresentation/1_Effective_Classroom_Management-Dr_Calderon.pdf Vizituar më 8 janar, 2020.

⁸ https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=1650256908340120&id=478341388865017&_tn_ =K-R# Vizituar më 4 janar, 2020.

e sigurisë dhe që ata mund të varen jo vetëm tek mësuesi, por edhe tek shokët dhe shoqet e klasës.

3. *Një mësues i mirë është i ngrohtë, i afrueshëm, entuziast dhe i kujdesshëm* - Ky mësues është i afrueshëm jo vetëm me nxënësit e klasës së tij por me gjithë shkollën. Ky është një mësues tek i cili fëmijët mund të shkojnë dhe t'i tregojnë problemet e tyre, shqetësimet apo edhe një histori qesharake. Një mësues i mirë është një dëgjues i mirë dhe që gjithmonë gjen kohën që t'u përkushtohet nxënësve të tij pavarësisht nga agjenda e ngarkuar. Nëse një mësues ka një ditë të keqe, askush nuk e di. Mësuesi nuk i përziën problemet e jashtme me shkollën.

4. *Një mësues i mirë vendos pritshmëri të larta për të gjithë nxënësit* - Ky mësues e kupton se pritshmëritë që ai ka për nxënësit e tij ndikojnë shumë në arritjet e tyre.

5. *Një mësues i mirë ka dashuri për të mësuarit dhe frymëzon nxënësit me pasionin e tij për arsimin dhe materialet e lëndës* - Ai vazhdimisht e rinovon veten si një profesionist në kërkim për t'i ofruar nxënësve të tij kualitet më të lartë të arsimit. Ky mësues nuk ka frikë të mësojë strategji të reja të mësimdhënies ose të përdorë teknologji të reja në orën e mësimit.

6. *Një mësues i mirë është një udhëheqës i aftë* - Ndryshe nga udhëheqësit administrativ, mësuesit efektiv fokusohen në vendimmarrjen e përbashkët dhe punën në grup, si dhe në ndërtimin e komunitetit.

7. *Një mësues i mirë mund të "ndërrojë marshin" dhe është fleksibil kur një mësim nuk po funksionin* - Ky mësues vlerëson mësimin e tij dhe gjen mënyra të reja për të prezantuar materialin për të siguruar që çdo nxënës të kuptojë konceptet kyçe.

8. *Një mësues i mirë bashkëpunon me kolegët në mënyrë të vazhdueshme* - Në vend të mendojë për veten si i dobët, sepse kërkon sugjerime apo ndihmë, ky mësues e sheh bashkëpunimin si një mënyrë për të mësuar nga një profesionist tjetër.

9. *Një mësues i mirë mban profesionalizëm në të gjitha fushat* – nga pamja personale deri te aftësitë organizative dhe gadishmëria për çdo ditë. Aftësitë e tij janë shembullore, nëse ai flet me një administrator, një nga nxënësit e tij ose një koleg. Respekti që mësuesi i mirë merr për shkak të mënyrës së tij profesionale është i dukshëm për ata rreth tij.

Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve

Të gjithë mësimitdhënësit duhet të kenë mundësi kualitative të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, të cilat mundësojnë përmirësimin e punës së tyre dhe suksesin e nxënësve. Trajnimet për mësimitdhënësit mund të organizohen nga vetë shkolla duke inkuadruar trajnerë të informuar me temën, ose mësimitdhënësit të dërgohen në vende të posaçme ku organizohen trajnime profesionale.

Sipas (Murati, 2009: 85) me zhvillim profesional kuptohet:

- Zgjerim dhe thellim të diturive teorike dhe praktikave mësimore
- Fuqizim dhe aftësim për të kryer punën mësimore më cilësore në një shkallë të përsosur e të re bashkëkohore
- Pasurim me njohuri, cilësi e veti të reja
- Fitim i përvojës më të madhe
- Rritje e aftësive për punë mësimore
- Përmirëson, shpie përpara metodat e punës.

Një gjë tjetër e rëndësishme është përdorimi i teknologjisë në klasë, për të cilën mësimitdhënësit duhet të trajnohen në vazhdimësi pasi teknologjia zhvillohet me hapa të shpejtë, por ajo që është më e trishtueshme është se disa mësimitdhënës, sidomos ata të moshës më të vjetër lëre që nuk dinë si ta përdorin mirë kompjuterin, por edhe refuzojnë ta mësojnë. Rast konkret që edhe gjatë pandemisë së Corona virusit, ku shkollat u mbyllën dhe mësimitdhënësit u obliguan që gjatë kësaj periudhe të mbajnë orët mësimore nëpërmjet platformës online, të cilët nëpër media janë ankuar se kanë hasur në vështirësi, pasi ajo ndonëse nuk është formë e komplikuar, për ata ka qenë një sfidë e vërtetë duke pasur parasysh edhe problemet teknike me të cilat janë ballafaquar.

Në pyetjen e pjesëmarrjes nëpër trajnime, (shih shtojcën 1), mësimitdhënësit u përgjigjën se kryesisht marrin pjesë, me disa përjashtime. Ata janë pjesëmarrës nëpër universitete verore, kampe trajnimi, seminare të organizuar nga BZHA (Byroja për Zhvillimin e Arsimit), konferenca

të ndryshme shkencore etj. Poashtu janë trajnuar për projektin e INA-s si dhe kanë realizuar aktivitete të ndryshme dhe janë inkuadruar në projekte të USAID-it si: “Leximi ju bën udhëheqës”, etj.

Bashkëpunimi me prindërit

Marrëdhëniet e mësimdhënësve me prindërit janë aleatët kryesor që mund të kontribuojnë në mbarëvajtjen e menaxhimit dhe procesit arsimor në klasë. Autorët si: (Ewing, Lowrie & Higgs, 2016: 195) rreth përfshirjes së prindërve potencojnë se “rëndësia e përfshirjes së prindërve në integrimin e ofruesve të tjerë të shërbimeve dhe grupeve të komunitetit përmirëson dukshëm rezultatet e nxënësve. Sa më efektiv komunikimi, aq më efektive përfshirja dhe përmirësimi i rezultateve të nxënësve”. (Groundwater-Smith, Ewing & LeCornu, 2007: 292-293) vërtetojnë se “në thelbin e preokupimeve të prindërve është brenga për mirëqenien e fëmijës së tyre. Janë të rrallë ata prindër të cilët nuk i duan shumë dhe nuk i marrin parasysh fëmijët e tyre. Dhe prapëseprapë, shumë prindër dhe kujdestarë qëndrojnë larg shkollave të fëmijëve të tyre, duke krijuar kështu bindjen se mosshfaqja e prindërve apo kujdestarëve në ngjarjet shkollore sinjalizon mungesë interesi për fëmijët e tyre”. Janë mësimdhënësit ata që duhet të kontribuojnë në kycjen e prindërve në shkollë, pasi që lidhje me ta është e rëndësishme. Nëse mësuesi zhvillon një urë lidhëse ndërmjet prindërve dhe klasës, ku prindërit pa droje do të afroreshin dhe angazhoheshin, vetë mësuesi do ta kishte më të lehtë menaxhimin dhe funksionimin e saj.

Nga përfshirja e prindërve në edukim nuk përfitojnë vetëm mësimdhënësit por të tre palët, pra lehtësohet puna e mësuesit, përmirësohet procesi i të nxënësve në klasë përmes aktivizimit të prindërve në procesin arsimor, përmirësohet komunikimi individual me prindërit etj. Te fëmijët rritet ndjenja e sigurisë kur sheh se prindërit e tij e vizitojnë shkollën, rritet vlerësimi dhe qëndrimi i tij ndaj shkollës, përmirësohen rezultatet etj. Nga ana tjetër prindërit kuptojnë më mirë mekanizmat, vështirësitë dhe mundësitë e procesit mësimor, zotërojnë metoda më të mira për të ndihmuar fëmijët në shtëpi, rritet vetëvlerësimi i prindërit, rritet kënaqësia për arritjet e fëmijës në shkollë etj. Prandaj shkolla duhet ta konsiderojë familjen si partner të saj. (Thaçi, 2013: 68) bashkëpunimin e mësuesit me prindërit e definon si “aktivitet sistematik, me qëllim dhe planprogram të organizuar, i udhëhequr dhe i përfunduar në formë konkluzione, të cilat obligojnë për punë më cilësore në zhvillimin dhe edukimin e mirë të nxënësve”. Ai poashtu shton se prindërit nuk duhet të zhvillojnë konsulta të shpejta me mësimdhënësin gjatë

orës mësimore, siç e praktikojnë disa prindër, por duhet të jetë vendosur një orar i posaçëm për të mos çrregulluar orarin e mësimeve. Përveç takimeve individuale, grupe dhe mbledhjet prindërore, ata mund të kontaktojnë edhe nëpërmjet telefonit apo formës me shkrim si nëpërmjet letrave prezantuese, broshurave, letra javore, jozyrtare etj. Mund të krijohet edhe “kutia e sugjerimeve”, ku prindërit mund t’i hedhin mendimet dhe idetë e tyre me shkrim me qëllim të përmirësimit të punës dhe shkëmbimin e ideve dhe pikëpamjeve të tyre. Gjithashtu mund të organizohen edhe vizita në shtëpi ku mësimdhënësit mund të njihen më mirë me fëmijën, kushtet dhe jetën e tij familjare.

Sipas (Murati, 2009: 174) bashkëpunimi shkollë-familje mundëson:

- Unifikim dhe harmonizim të ndikimit edukativ në zhvillimin e nxënësit, të riut
- Ofrimi i shanseve që prindët të njihen me qasje edukative, të kuptojnë ndryshimet, të mësojnë
- Krijimi i kushteve që prindërit edhe jashtë familjes të kyçen në procesin e edukimit të fëmijë së tyre
- Njohja me specifikat e fëmijës me qëllim të organizimit të mëtejshëm të punës edukative në familje
- Njohja me qasjet korrektive dhe kompensive të edukimit.

Mirëpo të shohim se sa mësimdhënësit e shkollave të hulumtuara e bëjnë të njejtën. Sipas përgjigjes së fituar nga ana e mësimdhënësve, (shih shtojcën 1), trekëndëshi prindër-nxënës-mësimdhënës sipas mësimdhënësve nuk është në nivelin e duhur, mbase ka nevojë për një bashkëpunim më të madh, pra nevojitet sensibilizim i të tre faktorëve, veçanërisht i prindërve dhe mësimdhënësve, pasi nxënësi është ende qenie në zhvillim dhe nuk mund të marrë përgjegjësi të plotë për të gjitha veprimet. Pra ne të gjithë e dimë se vendit tonë i mungon kultura e përfshirjes së prindërve në shkollë. Në ndërkohë ata u shprehën se kanë marrëdhënie të mira me prindërit si dhe zhvillojnë kontakte direkte në rast nevojë. Ndërkaq, gjatë anketimit të 40 prindërve, (shih shtojcën 3), ata u shprehën se kanë marrëdhënie të mira me mësimdhënësit dhe të njejtët merren me edukimin e fëmijëve.

KAPITULLI III - STILI I MËSIMDHËNIES

“If a child can’t learn the way we teach, maybe we should teach the way they learn.” **Ignacio Estrada.**

“Procesi i mësimdhënies kërkon aftësi të konsiderueshme për menaxhimin e një sërë detyrash e situatash që ndodhin në klasë çdo ditë. Këto aftësi, një mësues i fiton me praktikë dhe me dëshirën për të mësuar nga përvoja e mësuesve të tjerë. Po për fat të keq kjo është më e lehtë të thuhet, se sa të vihet në praktikë” (Bebi, 2017). Për të pasur një menaxhim të mirë të mësimit, duhet të fokusohemi në drejtimin dhe organizimin e veprimtarive të të nxënësve, me qëllim që të kemi përfshirje produktive të nxënësve në mësim dhe rezultate maksimale. (Brophy, 2003: 13) sugjeron: “mësuesit mund t’i përgatisin nxënësit duke iu sqaruar paraprakisht strukturën e përgjithshme të mësimit që do të vijojë me qëllim që ata të kenë të qartë rezultatet që pritet të arrihen si dhe strategjitë më të mira për të përvetësuar këtë mësim. Të mësuarit bëhet më i lehtë kur nxënësi njih natyrën edhe objektivat e lëndës, krijon lidhje mes mësimit të ri dhe njohurive që ka fituar më parë, si dhe kur është i ndërgjegjshëm së çfarë i kërkohet të bëjë më këtë lëndë”. Ndërkaq (Musai, 2003: 206) sqaron: “pavarësisht se cilat forma të punës mësimore mësimdhënësi ka vendosur t’i aplikojë gjatë orës mësimore, ai mund të bëjë edhe kombinimin e tyre me qëllim që të nxisë aktivitetin e përgjithshëm tek nxënësit”.

Mësuesi duhet ta njohë, ta kuptojë edhe ta pranojë teorinë për mënyrën e të nxënësve të fëmijëve. Kur mësuesi e njih dhe e pranon teorinë për zhvillimin e fëmijëve, atëherë ai e di se nxënësit kanë stile të ndryshme të të nxënësve dhe ai duhet ta përshtasë mjedisin për të nxënësve sipas nxënësve, të ofrojë më shumë opsione brenda klasës edhe të planifikojë aktivitete të cilat, përveç faktit se do të jenë në përputhje me programin mësimor, po gjithashtu do t’i takojnë stilet e ndryshme të të nxënësve të fëmijëve, dhe me anë të kësaj do të krijohet strategji e suksesshme për përmirësim të të nxënësve individual.

Nëse marrim për bazë vëzhgimet e kryera në klasë, (shih shtojcën 4), mund të themi se mësimi zhvillohet në mënyrë klasike me metoda monologu dhe dialogu dhe duke përdorur mjetet elementare siç janë libri dhe fletorja. Organizimi i orës mësimore është në nivel, ku mësimdhënësi vjen i përgatitur në orë dhe jep atmosferë të mirë, kontrollon panjohuritë, definon qëllimet, nxit interaksion etj. Ndërsa nxënësit reagojnë me bashkëpunime, tregojnë njohuri, parashtrojnë pyetje etj. Nga e gjithë kjo mund të shihet qartë se ora mësimore në këto shkolla fillore zhvillohet në mënyrë tradicionale duke e kombinuar pak me interaksion, të cilin vetëm disa mësimdhënës të ri mundohen ta implementojnë në orën mësimore, ndërsa mësimdhënësit e vjetër janë ende të orientuar në mësimin tradicional. Nuk përdoren mjete të mjaftueshme dhe material shtesë, të cilat do të nxisnin kuriozitetin e nxënësit dhe ora nuk zhvillohet në mënyrë aktive, dhe e përqëndruar tek nxënësi. Mirëpo nëse e shikojmë nga këndvështrimi tjetër, edhe nxënësit nuk kyçen në orë ashtu siç duhet dhe nganjëherë nuk kanë qëndrim serioz në punë.

Mësimdhënia efektive

Mësimi ka të bëjë me dhënien e njohurive në atë mënyrë që u intereson nxënësve. Mësimdhënia efektive matet me atë se sa një mësues është i aftë që të kapë njëkohësisht interesin e nxënësve, t'i mësojë ata dhe të ruajë rendin dhe disiplinën në klasë. Mësimi nuk mund të ndodhë në një klasë që menaxhohet keq, ku nxënësit nuk dëgjojnë dhe ku flasin pa qenë në temë.

Ekzistojnë disa elemente psikologjike, didaktike e sociale që ndihmojnë në realizimin e një mësimdhënieje efektive.⁹ Sipas (Brada, 2001: 22) “fjala didaktike ka prejardhje nga fjala greke didaskein, e cila në shqip ka kuptimin e teknikës së mësimdhënies”. Poashtu një mësimdhënie

⁹ <https://www.scribd.com/doc/303932988/Mesimdhënia-Dhe-Mesimnxënia-Efektive> Vizituar më 4 janar, 2020.

efektive është ajo që bazohet edhe në metodat dhe teknikat e mësimdhënies, të cilat e bëjnë më të lehtë të gjithë procesin.

Mësimdhënia efektive është bazë për të nxënë të suksesshëm. Bën lidhje me jetën reale, zhvillon të kuptuarit e thellë dhe monitoron e reflekton mbi të nxënë. Një mësimdhënie efektive nuk lidhet thjeshtë me informimin e nxënësve, por me involvimin e tyre. Edhe nxënësit nuk duhet të jenë pjesëmarrës pasiv që presin të mbushen me njohuri. Ata duhet të kyçen direkt në proces për të përfituar sa më shumë.

Mësimdhënie efektive zhvillohet në atë klasë ku zhvillohet mësim interaktiv. Ky mësim i përfshin nxënësit në mënyrë direkte dhe nuk bazohet në format tradicionale të mësimdhënies, meqë ato janë më pak efektive. Gjatë mësimin interaktiv janë nxënësit ata që vihen në qendër dhe komunikojnë në mënyrë aktive me mësuesin dhe me shokët. Mirëpo siç e cekëm edhe në njësinë paraprake, gjatë vëzhgimeve të kryera në klasë (shih shtojcën 4), në këto shkolla mësimi interaktiv nuk është në nivel të kënaqur dhe nuk mund të themi se kemi një mësimdhënie aq efektive.

Stile të ndryshme të mësimdhënies

Në klasën bashkëkohore, janë shfaqur pesë stile të ndryshme të mësimdhënies si strategji kryesore të miratuara nga mësuesit modern.¹⁰

- 1. Autoritar** - ky stil është i përqëndruar te mësuesi dhe shpesh përfshin seanca të gjata leksionesh ose prezantime të njëanshme. Nxënësit pritet të marrin shënime ose të absorbojnë apo mbajnë mend informacionin. Ky stil ofron pak ose aspak pjesëmarrje të nxënësve, duke e bërë të pamundur plotësimin e nevojave të secilit nxënë.

¹⁰ <https://resilienteducator.com/classroom-resources/5-types-of-classroom-teaching-styles/> Vizituar më 20 janar, 2020.

- 2. Delegates** - Ky stil është më i përshtatshmi për lëndët që kërkojnë punë në laborator, të tilla si kimi dhe biologji, ose lëndë që kanë reagime nga kolegët, si debatet dhe shkrimi krijues. Si delegates, mësuesi mund të marrë një rol vëzhgues për të inkurajuar mësimin nga ana e nxënësve. Stili delegates është stil modern dhe heq mësuesin nga pozita e autoritetit dhe e vendos atë në një rol konsultuesi.
- 3. Lehtësues** - Mësimdhënësit që adoptojnë stil lehtësues ose aktivitet të bazuar në veprimtari, inkurajojnë vetë-mësimin në klasë përmes rritjes së të mësuarit nga të tjerët. Për dallim nga stili i ligjëratave, mësuesit stimulojnë nxënësit që përgjigjen ta marrin me anë të pyetjeve e jo e njehta t'u servohet. Ky stil ka edhe disavantazhe pasi është një sfidë të lësh në duart e nxënësve zbulimin e gjithë fakteve në vend që t'ua tregosh atyre nga fillimi dhe pastaj t'i pyesish se çfarë kanë mbajtur mend.
- 4. Demonstrues** - Demonstruesi ruan autoritetin në klasë. Në vend që të mbështetet vetëm në një formë, stili demonstrues kombinon leksione me forma të tjera mësimore, duke përfshirë prezantime multimediale, demonstrime dhe aktivitete në klasë. Ky stil është veçanërisht i përshtatshëm për lëndët e muzikës, artit dhe edukimit fizik, ku kërkohen demonstrime për të kuptuar plotësisht temën. Megjithatë, në fusha të tjera të studimit, stili i demonstruesit mund të mos jetë i përshtatshëm. Ashtu si stili i autoritetit, mund të jetë e vështirë të akomodohen nevojat e të gjithë nxënësve.
- 5. Hibrid** - Disa mësues adoptojnë një stil të integruar mësimor që përfshin personalitetin, preferencat dhe interesat e tyre në mësimdhënie. Kjo strategji njihet si stili hibrid ose stili i përzier dhe është i popullarizuar në lëndët si anglisht, shkencë dhe studime fetare. Mësimdhënësit që përdorin stilin hibrid janë në gjendje të përshtasin mësimin për nxënës të ndryshëm, duke përfshirë njohuri ekstra-kurrikulare për të zhvilluar një njohuri më të thellë për një temë të veçantë. Sidoqoftë, disa kritikë pohojnë se stili hibrid mund të dobësojë procesin e të mësuarit, pasi mësuesit përpiqen të jenë gjithçka për të gjithë nxënësit.


Për të siguruar që nxënësit të marrin mësimin që funksionon për ta, është e rëndësishme që mësuesit të eksperimentojnë me stile të ndryshme dhe të sfidojnë veten e tyre të gjejnë një

strategji që do të arrijë tek secili nga nxënësit e tyre.¹¹ Mësuesit efektivë përdorin një sërë stiles, varësisht nga situata. Ata mendojnë kur dhe si ta ndryshojnë stilin varësisht nga rrethanat.

Tani të shohim se sa këto stile përdoren në shkollat fillore ku është kryer studimi. Sipas vëzhgimeve të kryera në klasë dhe sipas përgjigjeve të mësimeve, (shih shtojcën 1 dhe 4), stili autoritativ është stil që më tepër përdoret në arsimin e lartë, por fatkeqësisht është prezent edhe në shkollat fillore të përfshira në studim. Stilin delegues e praktikojnë më tepër mësimeve të reja, sidomos ato të gjuhës angleze. Stilin demonstrues nuk e hasim, apo e hasim shumë pak në shkollat e hulumtuara. Dhe stili i fundit apo ai hibrid nuk praktikohet apo praktikohet shumë rrallë në klasat e vëzhguara.

Poashtu ekzistojnë edhe shumë stile të mësimit, por më poshtë do të përmenden edhe tre të tjerë, të cilët në njëfarë mënyre përmbledhin të gjithë stilet.

Teaching STYLES



Burimi: Faculty focus¹²

- 1. Stili i drejtimit** apo udhëheqjes nxit mësimin përmes të dëgjuarit dhe ndjekjen e udhëzimeve. Me këtë stil, mësuesi u thotë nxënësve se çfarë duhet të bëjnë, si ta bëjnë atë dhe kur duhet të bëhet. Mësuesi ua jep nxënësve informacione përmes ligjeratave,

¹¹ <https://www.innovadesigngroup.co.uk/news/how-effective-are-these-five-teaching-styles/> Vizituar më 20 janar, 2020.

¹² <https://www.facultyfocus.com/articles/philosophy-of-teaching/three-teaching-styles/> Vizituar më 23 janar, 2020.

leximeve të caktuara, prezantimeve audio-vizuele, demonstrimeve, luajtjes së roleve dhe mjeteve të tjera.

2. **Stili i diskutimit** nxit mësimin interaktiv. Në këtë stil, të praktikuar nga Sokrati, mësuesi inkurajon të menduarit kritik dhe diskutimin duke u kërkuar nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve sfiduese. Mësuesi në këtë rast është lehtësues që e drejton diskutimin në një përfundim logjik. Nxënësit mësojnë të shprehin mendime dhe t'i mbështesin ato me fakte dhe të dhëna.
3. **Stili i delegimit** nxit mësimin përmes fuqizimit. Me këtë stil, mësuesi cakton detyra, të cilat nxënësit i punojnë në mënyrë të pavarur, individuale ose në grupe.

Nuk mund të themi se njëri stil është më i mirë se tjetri. Mësuesit efektiv përdorin një larmi stileshe, dhe e dinë se si dhe kur të zgjedhin më të përshtatshmin për një situatë specifike. Në klasat e vëzhguara arrihen të implementohen të tre stilet e lartpërmendur.

Strategji për të vetëorganizuar mësimin

Dhurata më e madhe, e cila mësuesi mund t'ua japë nxënësve të tij është t'u ndihmojë të zhvillojnë përgjegjësi për jetën e tyre, për punën e tyre dhe për shoqërinë. Mësuesit e shekullit XXI kanë plot mundësi t'u ndihmojnë nxënësve të zhvillojnë ndjenjë për të pasur përgjegjësi për nxënien e tyre. Si organizatorë, fëmijët do ta planifikojnë mësimin e vet dhe do sillen me ndërgjegjshmëri kah vendosjet e veta, do të mësojnë të bëhen partnerë, të bashkëpunojnë, dhe t'i kenë parasysh qendrimet dhe pikëpamjet e të tjerëve. Në doracakun e (Walsh et al., 32-33) sqarohet se mjedisi në të cilin mësohen vlera pozitive i çliron nxënësit dhe i motivon të mendojnë mëvetësisht kështu që duhet t'u ofrohen mundësi për të zgjedhur si për shembull:

- cilat materiale do t'i përdorin
- cilin aktivitet do ta punojnë
- në cilën mënyrë do ta realizojnë detyrën e përzgjedhur
- cilat aktivitete të tjera do t'i realizojnë në klasë.

Pra mësimdhënësit duhet të krijojnë kushte të cilat i stimulojnë fëmijët të marrin iniciativë në zhvillimin dhe mësimin personal. Përveç kushteve (Brophy, 2003: 14) sqaron se “mësuesi në ndërkohë duhet të tregojë edhe strategji për t’i aftësuar nxënësit që t’i përshtasin rrethanat e caktuara dhe t’i përdorin aty ku duhet dhe në mënyrë efektive që të ndërlidhin situatat dhe me pavarësi të krijojnë bindjet e veta rreth çështjeve të caktuara. Nëse mësuesi e thotë mësimin në mënyrë mekanike apo të izoluar, ka shumë gjasa që nxënësit mos të jenë në gjendje të përvetësojnë atë çka tregon ai. Pos kësaj duhet pasur kujdes qartësinë, koherencën, kronologjinë, demonstrimin, pasionin me të cilin flet, nxitjen e nxënësve, motivimin, kyçjen e nxënësve duke lejuar opinionet e tyre, ndihmë kur është e nevojshme, përmbledhjen e pikave kryesore, metoda të ndryshme dhe të përshtatshme për atë që mundohet të sqarojë, shembuj nga jeta e përditshme, poashtu edhe informacion që do t’i shërbejë jetës së përditshme e jo ngarkesa të kota që komplikojnë edhe gjërat e thjeshta. Nëse mësuesi përdor këto rregulla në klasë, edhe nxënësit do të vetëdijësohen për metodat që përdor ai, dhe marrin model se si duhet të mësohet, si duhet të organizohet një lëndë mësimore, cilat janë mënyrat më të lehta për ta kuptuar atë lëndë, cilat janë pikat më të rëndësishme që pastaj të ndërlidhet gjithë situata, dhe kështu nxënësit pavarësohen dhe mund të jenë në gjendje të vetëorganizojnë mësimin dhe ta përgatisin atë për ta sqaruar në orën e ardhëshme. Përveç si model, mësuesi duhet të tregojë në mënyrë konkrete se çfarë strategjishë duhet përdorur për një mësim efektiv, më të lehtë dhe për një kohë më të shkurter”.

(Brophy, 2003: 22-23) vazhdon duke shtuar se “mësuesi mund t’ju paraqesë strategji të ndryshme për të mbajtur mend më mirë si shpjegimi i lëndës me fjalët e veta, krijimi i lidhjeve me njohuritë e mëparshme, mbajtja e shënimeve etj.” Ndërkaq (Gartenschlaeger & Hinzen, 2002: 35) sqarojnë “koncepti i mësimin të vetëdrejtuar nënkupton përpunimin konstruktiv të informacioneve, përshtypjeve dhe përvojave:

- Për qëllimet e të cilave, pikat kyçe të përmbajtjes, rrugët dhe rrethanat e jashtme në thelb vendosen nga vetë nxënësit dhe

- Në këtë mes ata i përdorin dhe i drejtojnë me një synim të caktuar, mundësitë e të mësuarit të zhvilluara nga të tjerët dhe veprimtaritë mësimore të organizuara nga të tjerët, gjithmonë sipas nevojave vetiake dhe kushteve të dhëna”.

Prandaj mësimi i vetëdrejtuar është për t’u parë gjithmonë në lidhje me vetëvendosjen dhe përgjegjësitë vetiake. Si një kufizim i “mësimin të vetëorganizuar” është rrethana që në mësimin e vetëdrejtuar nuk është përcaktues fakti që individit organizon ecurinë e mësimin, por që individit vendos, se cilat mundësi të mësimin të vetëorganizuar dhe atij të organizuar nga të tjerët do të përfshihen në procesin e tij të mësimin. Mësimi në institucionet arsimore duhet të nxisë edhe zhvillimin personal të individit, të mundësojë të mësuarit e mënyrës se si mësohet dhe të kontribuojë që çdo person të mund të marrë përsipër më shumë përgjegjësi për fitimin e njohurive dhe aftësive të reja, që prej fillimit e më pas gjatë gjithë jetës.

Sipas përgjigjeve të mësimdhënësve në intervistë, (shih shtojcën 1), ata u shprehën se mundohen t’u tregojnë nxënësve strategji për të vetëorganizuar mësimin që të mund të punojnë në mënyrë më të pavarur dhe se të njëjtat do t’u nevojiten edhe në të ardhmen.

Memorizimi apo logjika

“Arsimi nuk është vetëm mësimi i fakteve por edhe trajnimi i mendjes për të menduar”. Einstein.

“Për të lehtësuar të mësuarit me logjikë dhe memorizimin e lëndës, përmbajtja duhet shpjeguar qartë duke e vënë theksin në strukturën e saj të përgjithshme si dhe në lidhjet që ekzistojnë” (Brophy, 2003: 14). (Brophy, 2003: 16) poashtu shton “pyetjet duhen formuluar në mënyrë të tillë që mësuesi të hapë një bashkëbisedim të rrjedhshëm dhe të ndërtuar rreth ideshë të fuqishme me nxënësit. Kështu, me anë të një dialogu, nxënësit mund ta përvetësojnë më mirë përmbajtjen dhe të logjikojnë rreth saj, e ajo çka kuptohet një herë, nuk harrohet”. Pra nëse

mësuesi ndërlidh idetë dhe situatat, i sqaron ato në mënyrë të thjeshtë dhe me shembuj konkret, nxënësit janë më të prirur për ta absorbuar këtë, se sa ta memorizojnë. Ne të gjithë e dimë se afati i memorizimit nuk është i gjatë dhe është absurde kur mësuesi kërkon nga nxënësi të njejtat gjëra që i ka thenë ai, pa i lënë hapësirë nxënësit ta analizojë dhe studiojë informacionin që e ka pranuar. Nga përvoja që kemi deri tani dihet se memorizimi nuk sjell gjëra të reja përveç përsëritjen e gjërave të njejtat që janë mësuar vite me radhë.

Memorizimi madje është instaluar edhe në kompjuterë, kështu që njeriut nuk i vlejnjë shumë ato që regjistron në kokë, por këto të dhëna dhe informata ai duhet t'i përdorë në mënyrë inteligjente, gjë që nuk arrihet nëpërmjet kompjuterit dhe të mundohet të vazhdojë të zhvillojë apo ndryshojë teoritë e deritanishme nëse ato janë gabim dhe të krijojë teori të reja të verifikuara shkencëtarisht. Meqë jemi te kompjuteri dhe te mundësitë e pakufizuara të Internetit, me më shumë rëndësi është që nxënësi të mësojë si t'i gjejë informacionet e nevojshme, se sa t'i memorizojë faktet që i ka thënë mësuesi. Gjithashtu, është e rëndësishme që secili nxënës të aftësohet që ai vetë t'i zhvillojë potencialet e tij. "Në shekullin XXI do të kemi nevojë për njerëz të cilët mund të zgjedhin probleme komplekse edhe të gjejnë teknika efektive për kryerje më të mirë të punës. Këtë duhet ta kuptojnë të gjitha palët e përfshira në procesin edukativo-arsimor, ata që e krijojnë politikën e arsimit, si dhe ata të cilat janë drejtpërdrejtë të përfshirë në mësimin – mësuesit, nxënësit dhe prinderit, si mësues të parë në jetën e fëmijës" (Walsh et al.). Kur jemi te prindërit, ata tentojnë me aq mundësi sa kanë ta dërgojnë fëmion nëpër kurse private sepse shkolla nuk është burim i mjaftueshëm. Këtë do ta ndërlidhim me thënjën e filozofit spanjollo-amerikan, George Santayana, i cili ka thënë se: "*Një fëmijë që është i edukuar vetëm në shkollë, është një fëmijë i paedukuar*". E pse të jetë kështu pasi shumë njerëz një kohë të gjatë të jetës e kalojnë në shkollë, andaj mësimi duhet të jetë sa më cilësor që kjo kohë të mos jetë e shkuar kot, por të jetë sa më efektive dhe produktive. E nëse të njejtën nuk arrin ta ofrojë shkolla, atëherë shtrohet pyetja se cili është qëllimi i ekzistencës së saj, apo është vetëm një biznes si shumë të tjerë?!

Nëse ndalemi të analizojmë të dhënat e fituara nga hulumtimet e kryera nëpërmjet metodës së vëzhgimit dhe metodave cilësore dhe sasiore, (shih shtojcën 1, 2, 3 dhe 4), vërehet se në këto pesë shkolla ndonëse ka një tentativë për të mësuar në mënyrë logjike, s'mund t'i iket aspak mësimit përmendësh apo memorizimit. Njësia mësimore e reduktuar apo kuptimi u diktohet nxënësve, e ata marrin shënime në fletore pa mos u munduar të nxjerrin vetë thelbin e njësisë dhe gjërat më kryesore dhe më pas të njejtën duhet ta mësojnë përmendësh.

Praktika

Sipas (Zajazi, 1994: 76-77) "sot të mësuarit modern është i orientuar qëllimisht në praktikë; përkatësisht mësojmë për të vepruar me sukses në punë dhe punojmë ashtu siç janë dituritë tona të fituara gjatë të mësuarit". Ndërsa (Brophy, 2003: 18) sqaron se "nxënësve duhet t'u jepen mundësi të mjaftueshme për të vënë në praktikë atë që po mësojnë si dhe këshilla për t'u përmirësuar. Mësuesi organizon aktivitete dhe jep detyra që i ofrojnë mundësi nxënësve të praktikojnë ose të zbatojnë atë që kanë mësuar. Praktika është një nga aspektet më të rëndësishme e megjithatë më pak të vlerësuara të mësimit në klasë. Mësuesi mund t'u kërkojë të fillojnë t'i zgjedhin detyrat e shtëpisë në klasë dhe pastaj t'i përfundojnë në shtëpi. Me këtë nënkuptojmë që nxënësit të shohin njëherë mënyrën se si shkon zgjidhja e detyrave, që kur të shkojnë në shtëpi të mund të punojnë në mënyrë të pavarur. Mësuesi poashtu duhet t'i kontrollojë detyrat e dhëna dhe të gjejë forma t'i nxisë nxënësit që mos i anashkalojnë ato me forma të ndryshme vlerësimi". Çdo teori që mësohet në klasë duhet të vendoset edhe në praktikë, përndryshe cili është kuptimi i gjithë kësaj teorie pa vënë asgjë në zbatim?!


Nga analizat e kryera me anë të metodave të përdorura në hulumtim, (shih shtojcën 1, 2, 3 dhe 4), është e qartë se praktika në këto shkolla qëndron në nivel jo të kënaqshëm, për të mos thënë se s'ekziston fare. Njëra nga arsyet është mungesa e kohës së mjaftueshme, pasi një orë mësimore është e pamjaftueshme për të zbatuar mësimin edhe në praktikë ndërsa arsyeja tjetër është mungesa e pajisjeve për të kryer punë praktike në shkollë.

KAPITULLI IV - ANALIZA E REZULTATEVE

Rezultatet e anketës së realizuar me nxënësit


Kjo anketë është realizuar me 75 nxënës të klasës VI, të 5 shkollave fillore në Komunën e Kërçovës.

Grafiku 1. Si qëndron ekologjia dhe klima e klasës tuaj?




Nga të dhënat e paraqitura me anë të këtij grafikoni vërehet se nga 75 nxënës, pjesa më e madhe, pra 50 nxënës apo 66.7% kanë deklaruar se ekologjia dhe klima e klasës së tyre është mesatare, një pjesë tjetër e përbërë prej 20 nxënësish apo 26.7% thonë se kanë ekologji dhe klimë të mirë, ndërsa një pjesë minimale, 5 veta apo 6.7% kanë shprehur pakënaqësi. Nga e gjithë kjo vërehet se ekologjia dhe klima e klasës kryesisht qëndron në një nivel mesatarë, gjë që varet nga shumë faktorë.

Grafiku 2. Si punoni më shpesh gjatë orës mësimore?




Në pyetjen e dytë shihet se pjesa dërrmuese e nxënësve apo 53.3% janë përgjigjur se gjatë orës mësimore më tepër punojnë në grupe, kurse një pjesë më e vogël 33.3% thonë se punojnë në çifte, ndërkaq një pjesë minimale 13.3% janë shprehur se punojnë në mënyrë individuale. Nga kjo mund të shihet se në këto shkolla nxënësit më shpesh punojnë në grupe pasi kjo është formë bashkëkohore e organizimit të mësimi.

Grafiku 3. Sa e nxisin mësuesit të menduarit kritik dhe anën kreative që keni ju si nxënës dhe a përdorin shprehje motivuese në klasë?




Gjatë kësaj pyetje një pjesë shumë e madhe, pra 53.3% janë përgjigjur se mësuesit e nxisin pak të menduarit të nxënësit dhe jo çdoherë përdorin shprehje motivuese në klasë, pastaj pjesa tjetër apo 28% thonë se janë të kënaqur e ndërkohë një pjesë më e vogël, apo 18.7% deklarohen se mësuesit aspak nuk e nxisin mendimin kritik dhe anën kreative të nxënësit. Nga grafikoni vërehet se kemi të bëjmë me një nivel mesatarë të nxitjes së mendimit të nxënësit dhe arsya mund të jenë mësimdhënësit, koha dhe kushtet që ofrojnë shkollat.

Grafiku 4. Kush i vendos rregullat e përgjithshme dhe disiplinore në klasë?




Në pyetjen e katërt se kush i vendos rregullat në klasë, më shumë se gjysma, pra 43 nxënës, apo 57.3% thonë se rregullat vendosen nga ana e mësuesit, 30 nxënës apo 40% thonë se rregullat i vendosin bashkë dhe 2.7% shprehen se rregullat vendosen vetë nga ana e nxënësve. Nga kjo paraqitje shihet se mësuesit ende mbajnë rolin autoritarë në klasë dhe nuk bashkëpunojnë aq sa duhet me nxënësit.

Grafiku 5. A përdorin mësuesit stile të ndryshme për t'ua lehtësuar mësimin?




Përgjigjet e pyetjes së pestë janë më pozitive, ku shihet se shumica e nxënësve, pra 42 apo 56% janë të kënaqur me stilet e ndryshme që përdorin mësuesit për ta lehtësuar mësimin, 29 apo 38.7% nxënës janë përgjigjur me “ndonjëherë” dhe një pjesë e vogël si 4 nxënës apo 5.3% shprehen se mësuesit asnjëherë nuk përdorin stile të ndryshme për të lehtësuar të nxënësit. Nga një pasqyrim i këtillë shihen meritat dhe munda të mësuesve që japin në klasë.

Grafiku 6. Mësuesi kërkon që mësimin ta mësoni përmendësh apo ta thoni ashtu si e keni kuptuar?



Gjatë pyetjes se a kërkohet mësim përmendësh apo kuptimi i mësimin, më shumë se gjysma, pra 41 nxënës apo 54.7% janë deklaruar se mësimdhënësi u kërkon të mësojnë përmendësh, ndërkohë që më pak se gjysma, 34 nxënës apo 45.3% thonë se duhet të mësojnë atë që kanë kuptuar. Nga grafiku dallojmë se kemi një garë të dyanshme ku më në fund fiton mësimi përmendësh. Kjo ngaqë mësimdhënësit s'mund t'u ikin rregullave që kanë mësuar me vite.

Grafiku 7. Sa e vendosni në praktikë njësinë e mësuar?




Dhe në pyetjen e fundit se a vendoset në praktikë njësia e mësuar, shumica e nxënësve, pra 42 nxënës, apo 56% janë shprehur me "ndonjëherë", 30 apo 40% e tyre kanë thënë se asnjëherë nuk e vendosin mësimin në praktikë dhe një pjesë minimale prej 3 nxënësish apo 4% thonë se çdo njësi vendoset edhe në praktikë. Nga këto të dhëna konkludojmë se mësimi në praktikë vendoset ndonjëherë dhe kjo për shkak të kohës, dhe mungesës së pajisjeve për të zhvilluar punë praktike në shkollë.

Rezultatet e anketës së realizuar me prindërit


Kjo anketë është realizuar me 40 prindër të nxënësve të klasës VI, të 5 shkollave fillore në Komunën e Kërçovës.

Grafiku 8. Si qëndron marrëdhënia me mësimitdhënësit e fëmijës tuaj?




Nga të dhënat e paraqitura me anë të këtij grafikoni shihet qartë se më shumë se 30 prindër kanë deklaruar se kanë marrëdhënie të mira me mësimitdhënësit e fëmijëve të tyre, ndërkaq një pjesë e vogël apo më pak se 10 prindër kanë raporte mesatare. Për opcionin e tretë të përgjigjes, nuk është përcaktuar asnjë, nga ku kuptojmë se ndërmjet mësimitdhënësve dhe prindërve ekzistojnë marrëdhënie të mira, të cilat nxiten nga ana e mësimitdhënësve.

Grafiku 9. A jeni të informuar me qëllimet dhe objektivat e vendosura në klasën ku mëson fëmiju juaj?




Nga grafiku i dytë mund të shihet se një pjesë e mirë e prindërve apo 24 prej tyre thonë se “ndonjëherë” janë të informuar me qëllimet dhe objektivat e klasës ku mësojnë fëmijët e tyre, një pjesë e konsiderueshme apo 16, thonë se janë të informuar çdoherë dhe një pjesë fare e vogël kanë thënë “asnjëherë”. Pra grafiku na jep pasqyrë ku mund të shohim se prindërit nuk janë gjithmonë të informuar për rrjedhat e klasës dhe kjo përgjegjësi bie mbi mësimdhënësit.

Grafiku 10. Sa nxisin mësimdhënësit mendimin kritik, problemor dhe krijues tek fëmiju juaj?




Grafiku i radhës rreth nxitjes së mendimit të nxënësit, nga pikëpamja e 24 prindërve më shumë qëndron në nivel të mesëm, 13 prej tyre janë të kënaqur dhe 3 të tjerë nuk janë aspak të kënaqur.

Grafiku 11. Mësuesi i fëmijës tuaj kërkon që fëmija të mësojë përmendësh apo vetëm të kuptojë atë që ka mësuar?



Sa i përket të mësuarit përmendësh apo të kuptuarit, shumica apo 23 prindër janë shprehur se fëmijët janë të udhëzuar të mësojnë përmendësh, ndërsa një pjesë jo e vogël e tyre apo 17 veta thonë se u kërkohet ajo që e kanë kuptuar. Grafiku lehtë na le të kuptojmë se këto dy çështje nuk janë larg njëra tjetrës, por gjithsesi mësimi përmendësh nuk e lëshon vendin e parë. Kjo qëndron kështu, pasi në këtë mënyrë me vite është mësuar në shkollë dhe inovacioneve u duhet kohë për t'u absorbuar dhe praktikuar.

Grafiku 12. A i vendosin në praktikë gjërat që i mësojnë në klasë?



Dhe për fund kemi praktikën, për të cilën 26 nga prindërit e nxënësve kanë thënë se ajo implementohet ndonjëherë, 8 nga 40 thonë “çdoherë” dhe 6 të tjerë thonë “asnjëherë”. Domethënë praktika në klasë sipas prindërve jo çdoherë është pjesë e mësimit dhe kjo ngaqë në shkollë nuk ka pajisje për të njejtën.

Përgjigjet kyçe nga intervistat e realizuara me mësime të mesimit

1. Si qëndron ekologjia e klasës në të cilën ju jeni përgjegjës dhe çfarë teknikash përdorni për të kaluar nga një aktivitet në tjetër gjatë orës mësimore?
 - Ekologjia është në një nivel të mesëm.
2. Në çfarë formash i ulni nxënësit për të punuar më mirë?
 - Më shpesh punojmë në grupe, pasaj në çifte etj.
3. Çfarë qëllimi dhe objektivash vendosni për t'i arritur me nxënësit?
 - Vendosim qëllime dhe objektiva afatshkurte dhe afatgjate dhe mundohemi që t'i arrijmë ato bashkë me nxënësit.
4. Si qëndron klima e klasës?
 - Kemi një klimë mesatarisht të mirë në klasë, për të cilën punojmë çdo ditë.
5. Sa dhe si punoni në zhvillimin e mendimit kritik, problemor dhe kreativ të nxënësit?
 - Punojmë me nxënësit çdoherë për t'ua zhvilluar mendimin kritik e kreativ.
6. Çfarë shprehjesh motivuese përdorni në klasë?
 - Shumë bukur, të lumt, bravo, ju jeni nxënës të mirë, inteligjentë etj.
7. A keni vendosur rregulla të përgjithshme dhe disiplinore në klasën tuaj? Nëse po a i keni vendosur vetë apo bashkë me nxënësit?
 - Po. Vendosim rregulla për disiplinën bashkë me nxënësit.
8. Sipas mendimit tuaj cilat karakteristika të shekullit XXI e dallojnë klasën tuaj nga klasa tradicionale?
 - Në klasë ka atmosferë të mirë për mësim, praktikohen metoda dhe strategji të reja, vendosen punime të nxënësve në klasë etj.
9. A merrni pjesë nëpër trajnime?

Po. Në kampe trajnimi, seminare të organizuar nga BZHA, konferenca të ndryshme shkencore, projektin e INA-s projekte të USAID-it, etj.
10. A funksionon siç duhet trekëndëshi prindër-nxënës-mësime të mesimit dhe si qëndron marrëdhënia konkretisht me prindërit?
 - Po, por ka mundësi të ketë një bashkëpunim më të madh. Kemi marrëdhënie të mira me prindërit si dhe zhvillojmë kontakte direkte në rast nevojë.

11. Cilat stile të mësimdhënies i përdorni në klasë? Autoritar, delegues, lehtësues, demonstrues apo hibrid?
- Përdorim stile të ndryshme që nxënësit ta kenë më të qartë njësinë mësimore si: stilin delegues, lehtësues, demonstrues etj.
12. A ju tregoni nxënësve strategji konkrete për të vetëorganizuar mësimin që të mund të punojnë në mënyrë më të pavarur dhe si e bëni këtë?
- Çdoherë mundohemi t'u tregojmë nxënësve strategji për të vetëorganizuar mësimin që të mund të punojnë në mënyrë më të pavarur. Kjo na i lehtëson punën edhe neve si mësimdhënës dhe kjo do t'u nevojitet edhe në të ardhmen, pra në studime.
13. Nga nxënësit kërkonti të mbajnë mend apo të logjikojnë?
- Nga nxënësit kërkojmë që ta kuptojnë mësimin, por ka disa gjëra që duhet t'i mbajnë mend si data, definicione etj.
14. Sa e vendosni në praktikë njësinë e mësuar dhe si qëndrojnë kushtet rreth kësaj?
- Çdoherë mundohemi që të bëjmë ushtrime apo si njëlloj përsëritje për mësimin e mësuar por një orë prej 45 minutave nuk mjafton që t'i bësh të gjitha. Poashtu shkolla s'ka pajisje adekuate dhe funksionale për lëndë të ndryshme si laboratorë për kimi dhe biologji, kabinete të informatikës etj.
15. A keni diçka tjetër të shtoni?
- Jo. Shpresojmë se në të ardhmen gjërat do të funksionojnë më mirë.

Përfundimi

Sa i përket pjesës teorike, të gjithë teoritë e autorëve të cituar më lart përkrahen dhe ndonëse menaxhimi i klasës dhe mësimdhënia mund të mësohen, ku secili mund të marrë një diplomë dhe ta quajë veten mësimdhënës apo të sigurojë një vend pune, por jo secili prej tyre e bën punën ashtu siç duhet dhe bëhet mësimdhënës i mirëfillt.

Në pyetjen se a dallon aspekti teorik nga ai praktik në menaxhimin e klasës mund të përgjigjemi se ekzistojnë dallime edhe pse çdoherë tentohet që teoria të përputhet me praktikën, gjithmonë ka lëshime që nuk zbatohen në praktikë. Edhe në klasat e përfshira në studim, qëndron e njejta.

Pyetja e dytë, se si duhet të menaxhohet klasa dhe cilat stile të mësimdhënies duhet përdorur në shkollë fillore, mund të themi se në çdo parregullsi që sheh mësimdhënësi në klasë duhet që bashkë me nxënësit të reagojë dhe ta përmirësojë atë. Vetëm duke punuar dhe duke u angazhuar do të fitohen rezultate pozitive në të gjitha aspektet. Ndërsa sa i përket stilit të mësimdhënies, vijmë në përfundim se asnjë stil nuk mund të zgjidhet si stili më e mirë, por është optimale kombinimi i të gjitha stileve të mësimdhënies me aktivitetet e të mësuarit. Kjo pasi nevojat dhe kërkesat e nxënësve ndryshojnë me zhvillimin e aftësive të tyre.

Një çështje tjetër ishte se a kontribon mësimdhënësi në krijimin e atmosferës pozitive në klasë. Mësimdhënësi është faktori kyç për krijimin e atmosferës pozitive në klasë. Nxënësit që kanë marrëdhënie të mira me mësuesin pranojnë më me lehtësi rregullat, procedurat dhe veprimet disiplinore. Arsimitari duhet t'i njohë shkathhtësitë e dëgjimit dhe reagimit, të jetë i ndershëm dhe me seriozitet t'i rreket zgjedhjes së problemit të nxënësit. Një veprim i tillë do të kishte sjellë shumë përmirësime shëndetësore, mentale dhe emocionale në të gjitha shkollat në vend. Nga përgjigjet dhe qëndrimet e mësimdhënësve të intervistuar, (shih shtojcën 1), vërehet se japin kontributin e tyre për një atmosferë pozitive në klasë, e cila rezulton me suksesin e nxënësve.

Gjatë punimit kemi gjetur shumë dallime ndërmjet klasës tradicionale dhe asaj bashkëkohore ku në klasën tradicionale vendimet i sjell mësuesi, aktivitetet bazohen mbi librin dhe fletoren, mësuesit janë burim i vetëm informacionesh, nxënësit më shpesh punojnë vetë, dihet me saktësi kur do të kryhet evaluimi gjatë gjithë vitit, nota merret në bazë të vetëm një kontrollimi të diturisë etj., ndërkaq në klasën bashkëkohore vendimet merren në mënyrë të përbashkët, aktivitetet bazohen mbi burime të ndryshme informatash, mësuesit janë lehtësues dhe udhëheqës në procesin e të nxënësve, nxënësit punojnë në çifte ose grupe të vogla, vlerësimi është i vazhdueshëm dhe kumulativ dhe vlerësimi përfundimtar varet nga shumë gjëra. Sa i përket kësaj teme mund të themi se klasat tona janë një përzierje e tradicionales dhe bashkëkohores, të cilat duhet ta minimizojnë funksionimin tradicional dhe t'i përshtaten bashkëkohores.

Në pyetjen tjetër të parashtruar se çfarë hapash duhet të ndërmerren për ta përmirësuar klimën konkludojmë se mësuesi duhet t'i mbështesë dhe t'i motivojë nxënësit, të krijohet atmosferë e këndshme, ndjenjë për përkatësi në bashkësi, nxënësit të përfshihen në marrjen e vendimeve, të ketë bashkëpunim, të dominojë nxitja dhe sjellja e mirë, energjia pozitive, entuziazmi, pritjet e mësuesit duhet të jenë të qarta për nxënësit, pjesëmarrje e drejtë dhe e barabartë etj. Menaxhimi është mënyra se si organizohet klasa dhe si ndikon në të gjithë klimën e klasës dhe sjelljen e nxënësve. Për të arritur gjithë këtë vijmë në përfundim se duhet t'i përfshijmë kriteret më themelore që ndërlidhen me menaxhimin e klasës, attribute këto, që duhet t'i posedojë dhe zbatojë çdo mësues në shkollën e sotme. Mësuesit e intervistuar, (shih shtojcën 1), mundohen që të përmirësojnë klimën në çdo aspekt.

A duhet trajnuar në vazhdimësi mësuesit për të pasur një klasë bashkëkohore? Kjo ishte pyetja e fundit për të cilën pa u menduar gjatë vijmë në përfundim se jo vetëm mësuesit që u kyçën në intervistë, por të gjithë mësuesit duhet të trajnohen në vazhdimësi për t'u përmirësuar puna e tyre dhe në këtë formë edhe sukcesi i nxënësve. Ajo që është aktuale dhe e rëndësishme është teknologjia, për të cilën mësuesit duhet të trajnohen në vazhdimësi,

sepse ajo është e pranishme dhe përdoret në arsim dhe e njëjta zhvillohet me hapa të shpejtë ku duhet që mësimit të jenë në hap me kohën.

Duke u bazuar në vëzhgimet e drejtpërdrejta në klasë, (shih shtojcën 4) mund të shihet qartë se ora mësimore në këto shkolla fillore zhvillohet në mënyrë tradicionale duke e kombinuar pak me interaksion, të cilin vetëm disa mësimit të ri mundohen ta implementojnë në orën mësimore, ndërsa kryesisht mësimit e vjetër janë ende të orientuar në mësimin tradicional. Nuk përdoren mjete të mjaftueshme dhe material shtesë, të cilat do të nxisnin kuriozitetin e nxënësit, dhe ora nuk zhvillohet në mënyrë aktive, dhe e përqëndruar tek nxënësi. Mirëpo nëse e shikojmë nga këndvështrimi tjetër, edhe nxënësit nuk kyçen në orë ashtu siç duhet dhe nganjëherë nuk kanë qëndrim serioz në punë.

Pra me bindjen më të lartë mund të themi se nëse një klasë ka menaxhimin e duhur dhe stile të duhura të mësimit aty zhvillohet mësim efektiv, i rregullt dhe pa pengesa. Si cilësia e mësimit ashtu edhe sjelljet e nxënësve dhe kreativiteti i tyre rriten dukshëm, meritat e të cilave i ka kryesisht mësimit, i cili arrin në këtë nivel duke pasur dije, durim dhe aftësi të mira menaxheriale, si me klasën në përgjithësi ashtu me secilin nxënës në veçanti, madje duke përfshirë edhe prindërit. Por duke e vëzhguar në mënyrë gjenerale dhe kritike aktivitetin dhe rolin e mësimit, si dhe angazhimin e nxënësve mund të thuhet se e bëjnë punën e tyre të domosdoshme, por jo edhe nga ana shpirtërore kontribuojnë për shkollën, e cila është institucion i shenjtë. Puna e secilit nuk është në nivel të kënaqshëm dhe nuk shihet ndonjë entuziazëm apo vullnet për punë më të mëdha dhe për ndryshime, të cilat do t'i gëzojnë vetë ata dhe gjeneratat e reja.

Diskutim rreth hipotezave

Sa u përket hipotezave që vendosëm në fillim të studimit, vijmë në përfundim se:

- Menaxhimi i mirë i klasës rrit cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpër shkollat fillore. Rreth kësaj shkollat duhet të punojnë më tepër.
- Klasa bashkëkohore nuk figuron në praktikë ashtu si në teori.
- Menaxhimi i klasës në mënyre bashkëkohore duke aplikuar stilet adekuate të mësimdhënies mundëson krijimin e një atmosfere efektive, të dobishme, stimuluese dhe pozitive të të nxënit.
- Klasa e shek. XXI është klasë e së ardhmes, por kjo klasë nuk është e pranishme aq sa duhet në shkollat e Maqedonisë.

Rekomandime

- Nëse i referohemi autorit (Larrivee, 2005: Vi), i cili thotë: "menaxhimi i klasës është një përbërës kritik në përzierjen e treanshme të strategjive efektive të mësimdhënies, i cili përfshin përmbajtje kuptimplote, strategji të fuqishme mësimore dhe një strukturë organizative për të mbështetur mësimin produktiv". Pra mësimdhënësit duhet të përdorin strategji të ndryshme pasi duke i kushtuar rëndësi menaxhimit efektiv të klasës krijojnë kushte për një mësim produktiv.
- T'i kushtohet më shumë rëndësi planifikimit të orës mësimore.
- Mësuesi të hy i pari në klasë ndërsa nxënësit pas tij.
- Nëse bazohemi në vëzhgimet e drejtpërdrejta (shih shtojcën 4), pjesa e fundit e orës mësimore duhet të përmbushet me aktivitete.
- Poashtu nëse bazohemi në vëzhgimet e drejtpërdrejta (shih shtojcën 4), puna në grupe duhet të zhvillohet në mënyrën e duhur.
- Sa u përket bashkëpunimeve me prindërit (shih shtojcën 1 dhe 3), dhe njëkohësisht duke iu referuar edhe autorëve të lartshënuar (Walsh et al.), "mësuesi në shekullin XXI e respekton rolin e prindërve në këtë fushë jashtëzakonisht shumë dhe për atë shkak bashkëpunon me familjet e nxënësve, për t'u krijuar unitet i cili do ta përforcojë sjelljen etike". Pra mësuesi duhet t'i përfshijë prindërit më tepër dhe t'ju japë rolin e merituar gjatë bashkëpunimeve me ta.
- Bazuar në përgjigjet e rrethuara të nxënësve shihet qartë se duhet të ketë më tepër bashkëpunim midis mësimdhënësve dhe nxënësve.
- Nëse i referohemi intervistës me mësimdhënësit dhe anketimit të nxënësve (shih shtojcën 1 dhe 2), vërehet se duhet të punohet rreth ekologjisë së klasës dhe përmirësimit të klimës në klasë.

- Mësimdhënësit në fillim duhet të zhvillojnë mendimin problemor dhe kritik, e më pas mendimin krijues të nxënësit.
- T'i kushtohet rëndësi individualitetit të nxënësit, e jo nxënësit të trajtohen si masë.
- Mësimi ndonjëherë të zhvillohet në ambiente të hapura për efekt më të mirë, nxitje dhe motivim.
- Duke iu referuar intervistave dhe anketimeve (shih shtojcën 1 dhe 2), duhet të përdoren më tepër fjalë motivuese nga ana e mësuesit.
- Sipas vëzhgimeve dhe përgjigjeve të mësimdhënësve (shih shtojcën 1 dhe 4), klasa e përbërë nga mësuesi dhe nxënësit duhet të tentojë më tepër t'i ngjajë klasës së shek. XXI.
- Mësimdhënësit të jenë më të përkushtuar, pasi që ndikojnë direkt në zhvillimin dhe motivimin e nxënësve.
- Mësimdhënësit fillimisht vetë të posedojnë veti të larta, që më pas të mund t'ua përcjellim edhe nxënësve.
- Bazuar në intervistat, (shih shtojcën 1), mësimdhënësit duhet të jenë pjesë e më shumë trajnimeve për të qenë në rrjedha me strategjitë e mësimdhënies dhe teknologjinë.
- Sipas analizës së rezultateve (shih shtojcën 1, 2 dhe 3), duhet të bëhet përforsim i trekëndëshit prindër-nxënës-mësimdhënës.
- Duke pasur parasysh raportet e observimit në klasë si dhe vëzhgimet në orën mësimore (shih shtojcën 1 dhe 4), duhet të eliminohet mësimi tradicional duke i dhënë përparësi më shumë mësimi interaktiv.
- Nëse bazohemi në vëzhgimet (shih shtojcën 4), dhe pikëpamjet personale, mësimi duhet të zhvillohet me nxënësin në qendër.

- Poashtu nëse bazohemi në vëzhgimet (shih shtojcën 4), dhe pikëpamjet personale, duhet të minimizohet stili autoritativ i mësimdhënies dhe të përdoren stile të ndryshme sipas nevojës.
- Kur marrim të analizojmë të gjithë indikatorët që grumbullohen të dhëna për këtë punim, (shih shtojcën 1, 2, 3 dhe 4), është e qartë se duhet të minimizohet mësimi përmendësh dhe të vlerësohen aftësitë, inteligjenca dhe logjika e nxënësve.
- Sipas metodave të kërkimit (shih shtojcën 1, 2, 3 dhe 4), mund të vijmë në përfundim se njësitë mësimore duhet të tentohet të vendosen edhe në praktikë.
- Mësimdhënësit t'u tregojnë nxënësve më shumë strategji për të vetëorganizuar mësimin që të mund të punojnë në mënyrë më të pavarur, (shih shtojcën 1).
- Duke e vëzhguar klasën në përgjithësi, si mësimdhënësit ashtu dhe nxënësit duhet të kontribuojnë më tepër dhe në çdo aspekt, meqë aty e kalojnë gjysmën e ditës dhe shkollën duhet ta konsiderojnë si shtëpi të dytë.
- Gjatë zhvillimit të intervistave, duke studiuar sjelljen e mësimdhënësve mund të konstatohej se shkollat janë të politizuara. Opinioni dhe rekomandimet rreth kësaj qëndrojnë në atë se shkolla është institucion i shenjtë, për të cilën paraardhësit tanë kanë luftuar, prandaj duhet ta ruajmë dhe ta zhvillojmë si është më mirë, e jo ta politizojmë.

Bibliografia

- Anderson, C. M., & Spaulding, S. A. (2007). *Using Positive Behavior Support to Design Effective Classroom*. Journal Articles; Reports - Descriptive.
- Borko, H., & Putnam, R. T. (1995). Chapter 2: *Expanding a teacher's knowledge base: A cognitive psychological perspective on professional development*. In T. R. Guskey & M. Huberman (Eds.), *Professional development in education: New paradigms & practices*. New York: Teachers College Press.
- Brada, R. (2001). *Metodika e gjuhës shqipe, për shkollën fillore*. Botimi II i plotësuar. Pejë: Biblioteka Pedagogjike.
- Brophy, J. (1999). *Perspectives of classroom management: Yesterday, today, and tomorrow*. In H. J. Freiberg (Ed.), *Beyond behaviorism: Changing the classroom management paradigm*. Needham Heights, MA: Allyn and Bacon.
- Brophy, J. (2003). *Doracak për arsimtarët; Educational practices series*. Shkup: IAE UNESCO.
- Cummings, C. (2000). *Winning Strategies for Classroom Management*. Alexandria, VA: Association for Supervision and Curriculum Development.
- Demiri, Sh., & Jankova, D. *Tejkalimi i stresit nëpër shkolla*. ISC, USAID, Sh. Q. "Doverba" Kumanovë: Bato print.
- Emmer, E. T. (1994). *Teacher managerial behaviours*. The international encyclopedia of Education.
- Evertson, C. M., & Harris, A. H. (1999). *Support for managing learning-centered classrooms: The classroom organization and management program*. In H. J. Freiberg (Ed.), *Beyond behaviorism: Changing the classroom management paradigm*. Needham Heights, MA: Allyn and Bacon.
- Ewing, R., Lowrie, T., & Higgs, J. (2016). *Mësimdhënia dhe komunikimi: Rishqyrtimi i përvojave profesionale*. Tetovë: Arbëria Design.
- Gartenschlaeger, U., & Hinzen, H. (2002). *Perspektiva dhe prirje në arsimin e të rriturve: Një përzgjedhje tekstesh aktuale për punën me projektet*. Instituti për Bashkëpunimin Ndërkombëtar i Shoqatës Gjermane të Shkollave të Larta Popullore (IIZ/DVV) dhe PARSH. Tiranë: K&B.
- Groundwater-Smith, S., Ewing, R., & LeCornu, R. (2007). *Teaching: challenges and dilemmas*. 3rd ed. South Melbourne, Vic.: Thomson.
- Larrivee, B. (2005). *Authentic classroom management: Creating a learning community and building a reflective practice*. Boston: Pearson.

- Merje, F. (2006). *Mjete për të mësuar në grup - Të mësosh në grup 2*. Shkup: Logos-A. *Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues: Orë mësimore të suksesshme*. (2008). Tiranë: Qendra për arsim demokratik.
- Miller, A. (1995). *Teachers' attributions of causality, control and responsibility in respect of difficult pupil behaviour and its successful management*. Educational Psychology.
- Murati, Xh. (2009). *Pedagogjia e menaxhimit*. Tetovë: Cabej.
- Musai, B. (2003). *Metodologji e Mësimdhënies*. Tiranë: Pegi.
- Nushi, P. (1999). *Psikologjia e përgjithshme II: Njeriu dhe personaliteti i tij në psikologji*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Popp, M. S. (2017). *Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë angleze në shkollat fillore: Libër i burimeve për zhvillim profesional*. Botimi i dytë. Arbëria Design.
- Randolph, C. H., & Evertson, C. M. (1995). Managing for learning: Rules, roles, and meanings in a writing class. *Journal of Classroom Interaction*.
- Thaçi, H. (2013). *Bashkëpunimi shkollë-familje*. Prishtinë: Olymp.
- Veseli, A. (1987). *Metodika e njohjes së ambientit*. Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore të KSA të Kosovës. Prishtinë: Rilindja.
- Walsh, K. B., Kiranxhiska, S., & Gjorgjieva, T. Ll. *Doracak: Krijimi i mjedisit për të nxënit për shekullin XXI*. USAID & AED. Shkup: Shën Kliment Ohridski. Vizituar më 4 janar, 2020.
https://www.stepbystep.org.mk/WEBprostor/Krijimi_i_mjedisit_p%C3%ABr_t%C3%AB_nx%C3%ABnit_p%C3%ABr_shekullin_XXI.pdf
- Williams, K. C. (2009). *Elementary Classroom Management: A Student-Centered Approach to Leading and Learning*. USA: Sage Publications.
- Willower, D, J., Eidell, T. L., & Hoy, W. K. (1973). *The school and Pupil control Ideology*. Educational Research. New York.
- Zajazi, T. (1994). *Efektet e mësimit të programuar laboratorik*. Tetovë: SE-soft.
- Zajazi, T. (2003). *Metodologji e mësimdhënies dhe mësimnxënies*. Shkup: Vinsent Graphic.
- Zylfiu, N. (1985). *Didaktika*. Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore.

Webografia

- Bebi, Xh. (2017). “Portali shkollor Albas”, në <http://www.portalishkollor.al/kuriozitet/mesimdhenia-eshte-art-dhe-te-tille-e-ben-vetem-mesuesi> Vizituar më 25 dhjetor, 2019.
- https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=1650256908340120&id=478341388865017&_tn_=-K-R# Vizituar më 4 janar, 2020.
- https://www.cfo-psy.org.ph/pdf/10thconferencepresentation/1_Effective_Classroom_Management-Dr_Calderon.pdf Vizituar më 8 janar, 2020.
- <https://edukimi.uni-gjk.org/upload/dokumentet/31943-Rilinda%20Dacaj%20.pdf> Vizituar më 15 janar, 2020.
- <https://www.scribd.com/doc/303932988/Mesimdhenia-Dhe-Mesimnxenia-Efektive> Vizituar më 4 janar, 2020.
- <https://resilienteducator.com/classroom-resources/5-types-of-classroom-teaching-styles/> Vizituar më 20 janar, 2020.
- <https://www.innovadesigngroup.co.uk/news/how-effective-are-these-five-teaching-styles/> Vizituar më 20 janar, 2020.
- <https://www.facultyfocus.com/articles/philosophy-of-teaching/three-teaching-styles/> Vizituar më 23 janar, 2020.

Shtojca

Shtojca numër 1 - Intervistë me kujdestarët e klasave dhe disa mësimdhënës

Shtojca numër 2 - Pyetësor për nxënësit

Shtojca numër 3 - Pyetësor për prindërit

Shtojca numër 4 - Vëzhgimet e drejtpërdrejta në klasë

Shtojca numër 1 - Intervistë me kujdestarët e klasave dhe disa mësimdhënës

1. Si qëndron ekologjia e klasës në të cilën ju jeni përgjegjës dhe çfarë teknikash përdorni për të kaluar nga një aktivitet në tjetër gjatë orës mësimore?
2. Në çfarë formash i ulni nxënësit për të punuar më mirë?
3. Çfarë qëllimi dhe objektivash vendosni për t'i arritur me nxënësit?
4. Si qëndron klima e klasës?
5. Sa dhe si punoni në zhvillimin e mendimit kritik, problemor dhe kreativ të nxënësit?
6. Çfarë shprehjesh motivuese përdorni në klasë?
7. A keni vendosur rregulla të përgjithshme dhe disiplinore në klasën tuaj? Nëse po a i keni vendosur vetë apo bashkë me nxënësit?
8. Sipas mendimit tuaj cilat karakteristika të shekullit XXI e dallojnë klasën tuaj nga klasa tradicionale?
9. A merrni pjesë nëpër trajnime?
10. A funksionon siç duhet trekëndëshi prinder-nxënës-mësimdhënës dhe si qëndron marrëdhënia konkretisht me prindërit?
11. Cilat stile të mësimdhënies i përdorni në klasë? Autoritar, delegues, lehtësues, demonstrues apo hibrid?
12. A ju tregoni nxënësve strategji konkrete për të vetëorganizuar mësimin që të mund të punojnë në mënyrë më të pavarur dhe si e bëni këtë?
13. Nga nxënësit kërkonit të mbajnë mend apo të logjikojnë?
14. Sa e vendosni në praktikë njësinë e mësuar dhe si qëndrojnë kushtet rreth kësaj?
15. A keni diçka tjetër të shtoni?

Shtojca numër 2 - Pyetësor për nxënësit

1. Si qëndron ekologjia dhe klima e klasës tuaj?
a) e mirë b) mesatare c) jo e mirë
2. Si punoni më shpesh gjatë orës mësimore?
a) në mënyrë individuale b) në çifte c) në grupe
3. Sa e nxisin mësuesit të menduarit kritik dhe anën kreative që keni ju si nxënës dhe a përdorin shprehje motivuese në klasë?
a) shumë b) pak c) aspak
4. Kush i vendos rregullat e përgjithshme dhe disiplinore në klasë?
a) mësuesi b) ju c) ju dhe mësuesi
5. A përdorin mësuesit stile të ndryshme për t'ua lehtësuar mësimin?
a) çdoherë b) ndonjëherë c) asnjëherë
6. Mësuesi kërkon që mësimin ta mësoni përmendësh apo ta thoni ashtu si e keni kuptuar?
a) përmendësh b) kuptimin
7. Sa e vendosni në praktikë njësinë e mësuar?
a) çdoherë b) ndonjëherë c) asnjëherë.

Ju faleminderit!

Shtojca numër 3 - Pyetësor për prindërit

1. Si qëndron marrëdhënia me mësuesin e fëmijës tuaj?
a) e mirë b)mesatare c) jo e mirë
2. A jeni të informuar me qëllimet dhe objektivat e vendosura në klasën ku mëson fëmiju juaj?
a) çdoherë b) ndonjëherë c) asnjëherë
3. Sa nxisin mësuesin mendimin kritik, problemor dhe krijues tek fëmiju juaj?
a) shumë b) pak c) aspak
4. Mësuesi i fëmijës tuaj kërkon që fëmija të mësojë përmendësh apo vetëm të kuptojë atë që ka mësuar?
a) përmendësh b)kuptimin
5. A i vendosin në praktikë gjërat që i mësojnë në klasë?
a) çdoherë b) ndonjëherë c) asnjëherë.

Ju faleminderit!

Shtojca numër 4 - Vëzhgimet e drejtpërdrejta në klasë

| | |
|----------------------------------|---|
| Fillimi dhe përfundimi i mësimit | <i>Njësia mësimore në disa raste përfundon para se të bie zilja. Nxënësit gjatë asaj kohe nuk janë të angazhuar me asgjë.</i> |
| Organizimi i punës në klasë | <i>Nxënësit në klasë janë të ulur në grupe, por kjo nuk do të thotë se punojnë punë grupore, me disa përjashtime të vogla.</i> |
| Klima dhe ekologjia e klasës | <i>Ekziston një klimë dhe ekologji mesatare në klasë.</i> |
| Nxitja e mendimit të nxënësit | <i>Nuk nxitet mendimi kritik dhe problemor dhe nuk i kushtohet aq shumë vëmendje mendimit krijues apo krijimtarisë së nxënësve.</i> |
| Mësuesi i mirë | <i>Mësimdhënësi posedon veti të ndryshme që e karakterizojnë mësuesin e mirë. Ekzistojnë marrëdhënie të mira mësues-nxënës.</i> |
| Stili i mësimdhënies | <p><i>Mësimi zhvillohet në mënyrë klasike duke përdorur formën mësimore individuale dhe grupore, me metoda monologu dhe dialogu dhe duke përdorur mjetet elementare siç janë libri dhe fletorja.</i></p> <p><i>Mësimdhënësi vjen i përgatitur në orë dhe jep atmosferë të mirë, kontrollon panjohuritë, definojnë qëllimet, nxit interaksion, etj. Ndërsa nxënësit reagojnë me bashkëpunime, tregojnë njohuri, parashtrojnë pyetje etj.</i></p> <p><i>Mësimi zhvillohet në mënyrë tradicionale duke e kombinuar pak me interaksion. Nuk përdoren mjete të mjaftueshme dhe</i></p> |

| | |
|-----------------------------------|---|
| | <i>material shtesë, të cilat do të nxisnin kuriozitetin e nxënësit, dhe ora nuk zhvillohet në mënyrë aktive, dhe e përqëndruar tek nxënësi. Mirëpo nëse e shikojmë nga këndvështrimi tjetër, edhe nxënësit nuk kyçen në orë ashtu siç duhet dhe nganjëherë nuk kanë qëndrim serioz në punë.</i> |
| Mësimdhënia efektive | <i>Mësimi interaktiv nuk është në nivel të kënaqur dhe nuk mund të themi se kemi një mësimdhënie aq efektive.</i> |
| Stile të ndryshme të mësimdhënies | <i>Gjatë orës mësimore është përdorur stili autoritativ. Stilin delegates më pak. Stilin demonstrues e hasim shumë pak dhe atë hibrid nuk praktikohet apo praktikohet shumë rrallë. Poashtu u përdor edhe stili i diskutimit.</i> |
| Memorizimi apo logjika | <i>Vërehet tentativë për të mësuar në mënyrë logjike, por s'mund t'i iket aspak mësimin përmendësh apo memorizimit. Kuptimi i mësimin u diktohet nxënësve ndërsa ata shkruajnë pa mos u munduar të nxjerrin vetë thelbin e njësisë.</i> |
| Praktika | <i>Praktika është në nivel të ulët, për të mos thënë se s'ekziston fare. Një orë nuk mjafton të kyçësh edhe praktikën, por nuk ka edhe pajisje.</i> |